



RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË UJIT NË KOSOVË NË 2013

Raporti për performancën e kompanive të licensuara të furnizimit me ujë,
shërbimeve të ujërave të zeza dhe furnizimit me shumicë me ujë të patrajtuar

Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim

Vizioni

“Shërbime cilësore, të sigurta dhe efikente të ujësjellësit dhe ujërave të zeza për të gjithë konsumatorët në Kosovë”

Misioni

“Rregullimi i shërbimeve të ujit në mënyrë efektive dhe transparente në pajtim me praktikën e mira Evropiane të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit të japin shërbime kualitative, të qëndrueshme dhe me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit Publik”.

PËRMBAJTJA

Fjala hyrëse	5
Roli dhe përgjegjësitë e ZRRUK	8
1 Hyrje	10
2 Zhvillimet në sektor	12
Pjesa A	
3 Performanca e Kompanive Rajonale të Ujësjellësit-Kanalizimit	
3.1 Furnizimi me ujë	18
3.2 Shërbimet për ujëra të zeza	36
3.3 Performanca financiare e KRU	43
3.4 Performanca e përgjithshme e KRU	46
3.5 Përgjegjëshmëria e KRU-ve ndaj ZRRUK-it	53
Pjesa B	
4 Performanca e sektorit të shërbimeve të Ujësjellësit-Kanalizimit	
4.1 Uji i prodhuar, shitjet dhe UPF	55
4.2 Mbulueshmëria me shërbime	56
4.3 Të ardhurat e planifikuara, qarkullimi dhe paraja e gatshme e arkëtuar	57
4.4 Shpenzimet kapitale (mirëmbajtja dhe rritja kapitale)	58
Pjesa C	
5 Performanca e furnizuesit të ujit me shumicë (NH Iber-Iepenci)	61
Pjesa D	
6 Aktivitetet e KKK	63
7 Sfidat për të ardhmën	64
SHTOJCA 1 Të dhënat e detajuara të performancës	67
SHTOJCA 2 Definicionet dhe arsyeshmëria	82
SHTOJCA 3 Pasqyrat përmbledhëse të të ardhurave	89
SHTOJCA 4 Pasqyrat tarifore(2013-2014)	92
SHTOJCA 5 Detajet kontaktuese	93
SHTOJCA 6 Zonat e shërbimit të KRU	95

Akronimet dhe shkurtesat

BE	Bashkimi Evropian
BD	Bordi i Drejtorëve
ASK	Agjensioni i Statistikave të Kosovës
KRU	Kompania Rajonale e Ujësjetës
PR	Kompania Rajonale e Ujësjetës, 'Prishtina' (Prishtinë)
PZ	Kompania Rajonale e Ujësjetës 'Hidroregjioni Jugor' (Prizren)
PE	Kompania Rajonale e Ujësjetës 'Hidrodrini' (Pejë)
MIT	Kompania Rajonale e Ujësjetës 'Mitrovica' (Mitrovicë)
GJA	Kompania Rajonale e Ujësjetës 'Radoniqi' (Gjakovë)
FE	Kompania Rajonale e Ujësjetës 'Bifurkacioni' (Ferizaj)
GJI	Kompania Rajonale e Ujësjetës 'Hidromorava' (Gjilan)
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
IL	NH 'Ibër Lepenci'
NJPM-NP	Njësia për Politika e Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
KKK	Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
NP	Ndërmarrje Publike
KNMU	Këshilli Ndër Ministror për Ujërat
TKP	Treguesit Kyç të Performancës
UPF	Uji i Pa-Faturuar
ZRRUK	Zyra Rregullatore për Ujësjetës dhe Kanalizim
IKU	Instituti i Kosovës për Ujëra
ARPL	Autoriteti i Rajonit të Pëllgjeve Lumore

FJALA HYRËSE



Një pjesë e rëndësishme e rolit tonë rregullator është për të monitoruar dhe raportuar mbi ecurinë e performancës së ofruesve të shërbimeve të ujit në përgjithësi dhe në veçanti në raport me objektivat e performancës dhe efikasitetit të përcaktuar me proceset rregullatore.

Në këtë mënyrë, ne sigurojmë që konsumatorët të marrin shërbimet në nivelin sa më të mirë të mundshëm. Përvoja e fituar me anë të raportimit për ofruesit e shërbimeve të ujit nga ana e rregullatorit, sugjeron që bërja publike dhe raportimi i performancës është provuar të jetë një mekanizëm i fortë për përmirësimin e performancës.

Gjatë këtyre viteve, janë bërë hapa të rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve të ujit për popullatën si kontribut i pandashëm i të gjitha palëve të interesit të lidhura me këtë sektorë. Ne jemi po ashtu të informuar me vazhden e përpjekjeve të përbashkëta të Qeverisë së Kosovës, partnerëve bashkëpunues (donatorëve) dhe shumë aktorëve të tjerë që janë duke kontribuar për të rritur mbulueshmërinë me shërbime dhe për të përmirësuar shërbimin e furnizimit me ujë dhe atë të ujërave të zeza. Ne po ashtu dëshirojmë të inkurajojmë Autoritetet lokale të cilët luajnë një rolë të rëndësishëm në rritjen e mbulueshmërisë me shërbime të furnizimit me ujë dhe shërbime të kanalizimit. Në këtë drejtim vlenë të theksohet se esenciale është koordinimi i tyre me ofruesit e shërbimeve dhe donatorët në zhvillimin e planifikimeve komunale dhe ofruesve të shërbimeve për të përmirësuar mbulimin me shërbime të ujësjellësit dhe të kanalizimit. Në të kaluarën ne kemi theksuar nevojën për t'u fokusuar në mbulimin e përmirësuar të shërbimeve të kanalizimeve dhe të trajtimit të ujërave të zeza të cilat vazhdojnë të mbetën, dukshëm me mbrapa se sa shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm.

Ne jemi në përfundim të procesit tarifor 3 vjeçar 2012-2014, Biznes planet e aprovuara nga rregullatori kanë qenë një lloj kontrate e nënkuptuar e detyrimeve në bazë të të cilave rregullatori ka qenë pajtuar me ato tarifa të cilat janë bazuar në detyrimin e marrë nga KRU për të dhënë rezultatet e përcaktuara në biznes planet e tyre. Ne kujtojmë se objektivat kanë qenë sfiduese por realisht të arritshme. Për një sukses të vërtetë KRU, është dashur të përpiqen me tepër për të përmbushur apo edhe për të tejkaluar të gjitha objektivat dhe jo vetëm disa prej tyre.

Projeksionet e aprovuara nga ZRRUK, përmes procesit tarifor kanë qenë shumë të nevojshme për ofruesit e shërbimeve për të balancuar përfitimet dhe kostot e përdorimit të ujit, duke siguruar të ardhura të mjaftueshme për qëndrueshmërinë afatgjate financiare të biznesit të furnizimit me ujë. Sidoqoftë, edhe të ardhurat (arkëtimet) e ulta kanë kufizuar kapacitetin financiar të KRU për të bërë një kontribut më të lartë për investimet. Në pajtim me praktikën e mirë rregullatore, qasja jonë ka qenë e orientuar drejt rezultateve konkrete. Kryesisht ne kemi qenë të interesuar në lidhje me nivelet e shërbimit dhe shpenzimet e përgjithshme. Pra, ne nuk kemi ndërhyrë drejtëpërdrejtë në menaxhimin ditor të ofruesve të licensuar të shërbimeve, duke e lënë këtë përgjegjësi për menaxhmentet si dhe bordet e ofruesve të shërbimit.

Megjithatë pritjet e rregullatorit në vazhdimësi e veçanërisht gjatë këtij procesi aktual tarifor kanë qenë në:

(i) Përmirësimet e efikasitetit financiar dhe operative;

- **Reduktimi shpenzimeve operative**, Shpenzimet operative të KRU dominojnë nga shpenzimet në personel dhe energji, e ku kostoja e kombinuar është rreth 75% të shpenzimeve të përgjithshme operative. Fuqimisht jemi të mendimit se shpenzimet operative të KRU janë shumë më të larta se sa që ato do të duhej të ishin, ato kanë ndikuar direkt në tarifa. Poashtu jemi të mendimit se këto shpenzime operative janë jo efektive me personel të shumtë në shumicën e kompanive ndoshta edhe në të gjitha. Gjatë procesit të caktimit të tarifave shpenzimet operative kanë qenë të sfiduara dhe përmes kësaj kemi

synuar një reduktim në shpenzimet operative vjetore prej rreth 12%, nga nivelet e paraqitura nga KRU në biznes planet e tyre fillestare. Ne kemi paraparë që këto dobi nga efienca operative do të bëhen përmes reduktimit të shpenzimeve në personel të KRU, edhe pse janë të mundshme edhe kursimet në fushat tjera (me kusht që nuk do të rezultonte në përkeqësim të niveleve të shërbimit).

- **Ngritja e efiençës së arkëtimit**, shkalla e ulët e arkëtimit të faturave vazhdon të jetë pika më e dobët e performancës së këtij sektori. Edhe pse vit pas viti është shënuar përmirësim sa i përket arkëtimit prapë është në vlera shumë të ulëta, ende rreth 30% e borgjeve të konsumatorëve për shërbimin e ujit nuk mund të mblidhen. Me normën aktuale të arkëtimit prej (71%), përveç faktit se shumica e kompanive të ujit kanë qenë në gjendje të financojnë kostot e tyre të operimit dhe mirëmbajtjes, kapacitetet e tyre për investime kapitale kanë qenë shumë të kufizuara dhe të varura nga donacionet dhe grantet. Edhe pse performanca në arkëtimin e të ardhurave është duke u përmirësuar vendosmërisht jemi të mendimit se përmirësimet janë shumë të ulëta se sa ato që do duhej të ishin. Ne besojmë se KRU kanë një shkallë të lartë të humbjeve komerciale (kyçjet e paligjshme dhe aktivitetet e dobëta rreth faturimit) të cilat mund të përmirësohen dhe të gjenerojnë të hyra nga shërbimet e furnizimit me ujë dhe shërbimet e ujërave të zeza.
- **Reduktimi i ujit të pa-faturuar (UPF)** nga KRU, UPF është tepër e lartë dhe në nivel sektori kapë vlerën prej 57%. Ky është një nivel i pa akceptueshëm dhe larg normave të vendeve Europiane. Përveç faktit se UPF, nuk sjellë të ardhura për kompaninë, krijon shpenzime shtesë për prodhimin dhe distribuimin e tij. Për me tepër është për keqardhje se humb një sasi e konsiderueshme e ujit e cila është shumë e nevojshme për të plotësuar kërkesat në ato zona të cilat kanë mungesë kronike të ujit. Përkundër, angazhimeve vetanake por edhe të mbështetjes së herë pas herë të donatorëve, KRU nuk ishin në gjendje që të zgjidhnin situatën alarmuese të humbjeve së ujit. Përkundrazi, UPF ka stagnuar në nivel të lartë me disa ndryshime minore e cila me tepër mund ti atribuohet më shumë lëvizjeve në zvogëlimin e prodhimit të ujit. Ne mendojmë se reduktimi i UPF, është një çështje shumë komplekse, prandaj pa një qasje strategjike të KRU, ndaj kësaj sfide nuk është e mundur të shënohen rezultate esenciale.

(ii) **Rritja e investimeve kapitale**, ne po ashtu kemi lejuar mundësi realiste për investime, por, në mënyrë që këto investime të financohen nga kompanitë ka qenë e domosdoshme që të përmirësojnë arkëtimin e të ardhurave nga konsumatorët. Pa këto mjete financiare KRU kanë qenë të pafuqishme për të përmbushur nivelin e tyre të shërbimit dhe detyrimet e investimeve. Në vitin 2013 nga të gjitha KRU janë, realizuar vetëm 48% të investimeve të planifikuara për përmirësimin e shërbimeve.

(iii) **Rritja e mbulueshmërisë dhe ngritja nivelit të shërbimit**, gjatë rishikimit tonë të planeve të biznesit të KRU, ne nuk kemi sfiduar projeksionet në lidhje me planet për rritjen e numrit të konsumatorëve. Kemi konsideruar se rritja e numrit të konsumatorëve do të gjeneroj të ardhura shtesë, në mënyrë që KRU të jenë në gjendje ti përmbushin objektivat e tyre të investimeve.

Ne megjithatë i sygjerojmë, ofruesit e shërbimeve të përqëndrohen edhe me tutje në treguesit sfidues, në mesin e tyre; përmirësimin e faturimit dhe arkëtimit sidomos nga konsumatorët shtëpiak dhe komercial, reduktimin ujit të pafaturuar, ngritjen shërbimeve në raportin e marrëdhënjeve me konsumatorë, përfshirë shqyrtimin dhe trajtimin e ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve të tyre në menyre sa me efektive, si një çështje shumë e domosdoshme për të ngritur besimin tek ofruesi i tyre i shërbimit.

Ne shpresojmë që Kompanitë e ujit, Rregullatori, Qeveria e Kosovës, Politikë-bërësit dhe të tjerët do të jenë në gjendje që ti përdorin të dhënat në këtë raport si një pikë referimi për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së shërbimeve të ujit dhe kanalizimeve si dhe për të ndihmuar politikat e ardhshme të lidhura me planifikimet në industrinë e shërbimeve të ujit në Kosovë.

Përfundimisht unë dua të përgëzoj kompanitë, të cilat kanë treguar përmirësim të performancës së tyre gjatë vitit 2013. Në mënyrë të veçantë do të doja të falënderoj zyrtarët e kompanive, të cilët kanë raportuar dhe vazhdojnë të raportojnë për ZRRUK.

Gjithashtu përgëzoj të gjithë stafin e ZRRUK të angazhuar në procesin e raportimit dhe përpunimit të dhënave për analizën dhe diskutimin konciz në këtë raport.

Raif Preteni

Drejtor i ZRRUK



ROLI DHE PËRGJEGJËSITË E ZRRUK

Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim, është rregullator ekonomik i sektorit të shërbimeve të ujit në Kosovë. Roli i të cilit në sektorin e furnizimit me ujë dhe shërbimeve të ujërave të zeza është për të siguruar se ofruesit publik të shërbimeve, nuk keqpërdorin pozitën e tyre monopoliste, por të ofrojnë një standard të arsyeshëm të shërbimit me një çmim të drejtë dhe se të drejtat dhe detyrimet e tyre të ndërsjellta, janë të balancuara në mënyrë të drejtë. Shoqëria jonë ka përfituar në mënyrë të konsiderueshme nga ekzistenca e ndërhyrjes rregullatore duke futur ekuilibër më të madhë në marrëdhëniet në mes të ofruesve të shërbimeve dhe përdoruesve (konsumatorëve) të tyre. Meqenëse natyra e këtij shërbimi është e karakterit të monopolit natyror dhe faktit se ka mungesë të nxitjes për të kërkuar efikasitet dhe efektivitet më të madhë, ka një prevalencë në rritje të rreziqeve për përdoruesit që ata të mos marrin një shërbim të dëshiruar.

Furnizimit publik me ujë dhe shërbimet e ujërave të zeza, janë thelbësore për mirëqenien e qytetarëve, shëndetin publik dhe aktivitetet ekonomike.

Përgjegjësia e ZRRUK, në bazë të ligjit Nr.03/L-086, është e kufizuar vetëm me ndërmarrjet Publike (NP), dhe nuk përfshinë skemat private të ujësjellësve në zonat rurale.

Në mënyrë më specifike roli dhe përgjegjësitë kryesore të ZRRUK mund të specifikohen si në vijim:

- Përcaktimi i tarifave në nivele të mjaftueshme për ofruesit e shërbimeve për të financuar aktivitetet e tyre në përputhje me standardet e obligueshme të shërbimit dhe në nivel të pranueshëm të pritjeve për shërbime, por në të njëjtën kohë duke promovuar eficientësinë për të siguruar që tarifat nuk janë më të larta se sa duhet të jenë;
- Liçensimi i ofruesve të shërbimeve të furnizimit me ujë, si dhe sigurimi që ofruesit e shërbimeve përmbushin obligimet e tyre në lidhje me nivelin e shërbimeve;
- Vendosja e standardeve për shërbimet e ofruara për konsumatorët si dhe monitorimi i zbatueshmërisë së tyre nga ana e ofruesve të shërbimeve;
- Mbrojtjen e interesave të konsumatorëve duke siguruar që ofruesit e liçensuar të shërbimeve nuk keqpërdorin pozitën e tyre monopoliste dhe duke siguruar që shërbimet e ofruara të jenë në përputhje me standardet e vendosura;
- Sigurimi i mekanizmave për konsumatorët që të parashetrojnë ankesa ndaj ofruesve të shërbimeve;
- Përcaktimi i obligimeve dhe të drejtave të ndërsjellta për ofruesit e shërbimeve dhe konsumatorëve, si dhe monitorimi i zbatueshmërisë së tyre.

Për më tepër një nga funksionet e tij rregullatore është edhe stimulimi i konkurrencës në sektorët e shërbimeve të ujit përmes krahasimit (benchmarking) si dhe raportimit të rregullt të performancës; Roli i monitorimit dhe raportimit nga ana e ZRRUK, po ashtu është i rëndësishëm për shkakun se ofron informata të besueshme dhe të qëndrueshme e që mund të përdoret për të:

- Identifikuar performancën e dobët dhe atë të mirë me qëllim të ofrimit të stimulimit për ofruesin e shërbimit për të përmirësuar punën e tyre me kalimin e kohës,
- lejuar të bëhen krahasime në mes të ofruesve të shërbimeve dhe në këtë mënyrë të lehtësohet konkurrenca nga krahasimi e që mund të inkurajoj ofruesit e shërbimeve për të përmirësuar performancën e tyre në raport me të tjerët si dhe,
- mbanë aktorët e përfshirë, të informuar në lidhje me punën dhe aktivitetet e ofruesve të shërbimeve përmes shpërndarjes së informacionit të shërbimit tek publiku, konsumatorët si dhe institucionet (Rregullatorin, Kuvendin dhe Qeverinë e Kosovës) dhe donatorët me qëllim të lehtësimit të vendim-marrjes për ndërmarrjet publike të shërbimeve të ujit.

Gjatë punës së tij, ZRRUK udhëhiqet nga praktikat e mira rregullative të bazuara në parimet:

Pavarësisë: Ekzekutimi me profesionalizëm por në mënyrë të pavarur i mandatit rregullator dhe përgjegjësi ligjore në interes të qytetarëve të Kosovës.

Balancimit: Përcaktimi i tarifave të balancuara të shërbimit të cilat u mundësojnë ofruesve të liçensuar që të ofrojnë shërbimet në përputhje me standardet dhe kërkesat relevante, por të cilat po ashtu marrin parasysh mundësitë për pagim nga popullata.

Objektivitetit: Monitorimi efektiv si dhe vlerësimi objektiv dhe transparent i punës së ofruesve të liçensuar të shërbimeve duke bërë krahasime të duhura në baza vjetore për performancën e tyre.

Mbrojtja e Interesave të Konsumatorëve: Trajtimi i kontesteve dhe ankesave të konsumatorëve në mënyrë efektive dhe të drejtë dhe duke involvuar ofruesit e liçensuar të shërbimeve në këtë proces.

Konsultimit: Konsultimi me palët e interesit për të siguruar njohuri për pikëpamjet dhe prioritetet e tyre përmes shkëmbimit të informatave, memorandumëve të bashkëpunimit, mbajtjes së punëtorive, publikimit të raporteve relevante në web-faqen e vet, dhe përmes shtatë Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve. Jo më pak e rëndësishme është edhe ofrimi i këshillave Qeverisëse për hartimin dhe rishikimin e politikave.

Transparencës: Publikimi i informatave në mënyrë të hapur dhe transparente për tu mundësuar të gjitha palëve të interesit që të kuptojnë dhe participojnë në vendimet rregullatore të cilat i merr ZRRUK.

Bashkëpunimit: Bashkëpunimi me të gjitha palët e interesit dhe në veçanti me institucionet tjera të sektorit të shërbimeve të ujit në Kosovë (siç janë MMPH dhe IKSHPK) për tu siguruar se përgjegjësitë e palëve të ndryshme janë të përkufizuara qartë. Po ashtu, ky parim i referohet edhe bashkëpunimit me rregullatorët tjerë ekonomik të shërbimeve të ujësjellësit në regjion dhe në Europë me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe aplikimit të praktikave më të mira.

Mos-diskriminimit: Sigurimi se tarifat e shërbimit me të cilat ngarkohen konsumatorët janë të drejta dhe nuk bëjnë diskriminim apo demonstrojnë preferenca për cilëndo kategori të konsumatorëve.

Ky është raporti i tetë vjetor i publikuar nga Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim për ecurinë e performancës së të gjithë ofruesve të shërbimeve në vend të cilët, ofrojnë shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit dhe të ujit me shumicë. Raporti është përgaditur nga ZRRUK dhe analizon performancën e KRU gjatë vitit 2013/2012. Raporti është përgaditur nga të dhënat e ofruara nga kompanitë dhe të verifikuara në mënyrë të pavarur nga Rregulatori. Raporti i performancës përfshin një numër treguesish të performancës që sigurojnë informacion të besueshëm dhe të qëndrueshëm dhe mund të përdoren për të: informuar dhe ngritur diskutim tek palët e interesit të sektorit, identifikuar ndryshime në rezultatet e performancës si dhe stimuluar 'konkurrencën nga krahasimi', në mes të ofruesve të shërbimeve të ujit.

Raporti ofron të dhëna statistikore dhe paraqitje në formë grafike për shumë tregues kyç për ta bërë atë të lehtë për të identifikuar tendencat e performancës për çdo kompani, si dhe për të krahasuar performancën në gjithë industrinë si një tërësi, pra është një pasqyrë ku ofruesit e shërbimit, mund të identifikojnë pikat e forta dhe dobësitë e tyre si dhe të krahasohen me simotrat e tyre brenda vendit.

Pas vitit 2003, sektori i shërbimeve të ujit në tërësi i është nënshtruar procesit të konsolidimit përkatësisht rajonalizimit. Në vitin 2008 përfundimisht ndërmarrjet e ujit, shndërrohen në shoqëri aksionare me emërtimin: Kompania Rajonale e Ujësjellësit si Shoqëri Aksionare, që ofron shërbime të furnizimit me ujë dhe shërbime të ujërave të zeza në zonën e saj respektive të shërbimit.

Bazuar në Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike, Nr.03/L-087, i aprovuar në vitin 2008, përcaktohet korniza ligjore, lidhur me pronësinë mbi Ndërmarrjet Publike dhe qeverisjen e tyre korporative në përputhje me parimet e njohura ndërkombëtare. Në këtë ligj po ashtu KRU, janë definuar si Ndërmarrje Publike në pronësi të Republikës së Kosovës, të organizuara si shoqëri aksionare, përgjegjëse për sigurimin e furnizimit me ujë dhe shërbimin e ujërave të zeza në vend. Përderisa, Qeveria e Kosovës ka kompetenca ekskluzive për ushtrimin e të drejtave të aksionarit¹ të Republikës së Kosovës. Kompanitë Rajonale të Ujësjellësve, udhëhiqen nga Bordi i Drejtorëve i zgjedhur nga Qeveria e Kosovës, me mandat për të mbikëqyrë afarizmin e saj. Gjithsejtë janë 7 KRU që ofrojnë shërbimet e tyre në mbarë vendin të cilat i janë nënshtruar, procesit Rregullatorë të udhëhequr nga Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-086 dhe rregullat e dala prej saj.

Kompanitë Rajonale të Ujësjellësve, janë përafërsisht të njëjta në aspektin e madhësisë, shërbimit që ata ofrojnë dhe mjediset në të cilat ato operojnë, përjashtuar KRU 'Prishtina' e cila është kompania me e madhe. Vlerësohet se KRU 'Prishtina', ofron shërbime për 1/3 e popullatës së Kosovës. Shtatë KRU veprojnë në kuadër të zonave rajonale gjeografikisht të përcaktuara për ofrimin e shërbimeve në të cilat janë përfshirë të gjitha komunat në vendi.

Kompani publike rajonale të liçencuara nga ZRRUK, janë:

1. KRU 'Prishtina' Sh. A., që ofron shërbimet në komunat: Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq, Graçanicë, Podujevë, Lipjan, Shtimje dhe Drenas;
2. KRU 'Hidroregjioni Jugor' Sh.A, që ofron shërbimet në komunat: Prizren, Malishevë, Suharekë dhe Dragash;
3. KRU 'Hidrodrini' Sh.A., që ofron shërbimet në komunat: Pejë, Istog, Klinë, Junik dhe Deçan;
4. KRU 'Mitrovica' Sh.A., që ofron shërbimet në komunat: Mitrovicë, Skënderaj dhe Vushtrri;
5. KRU 'Hidrosistemi Radoniqi' Sh.A., që ofron shërbimet në komunat: Gjakovë dhe Rahovec;

¹ Përveq KRU "Bifurkacioni" aksionare e të cilës janë Komunat: Ferizaj dhe Kaçanik.

6. KRU 'Hidromorava' Sh.A., që ofron shërbimet në komunat: Gjilan, Kamenicë, dhe Viti;
7. KRU 'Bifurkacioni' Sh.A., që ofron shërbimet në komunat: Ferizaj dhe Kaçanik.

Kompania e vetme e licencuar që ofron ujë me shumicë është: NH 'Ibër-Lepenci' Sh.A. e cila furnizon ujë me shumicë për KRU 'Mitrovica' Sh.A. dhe për KRU 'Prishtina' Sh.A.

Në këtë raport për Kompanitë Rajonale të Ujësjellësve (KRU), në raste të caktuara përdoren edhe termat, ofruesit e shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të zeza apo Ndërmarrje publike, varësisht prej kontekstit.

Raporti përbëhet nga 4 pjesë qendrore (A,B,C dhe D), dhe një numër shtojcash.

Pjesa A, është thelbi i këtij raporti ku ne ofrojmë informacione, analiza dhe komente për performancën e shtatë KRU. Në këtë analizë shqyrtohet, performanca relative e KRU në lidhje me shërbimet e furnizimit me ujë, shërbimet për ujërat e zeza dhe menaxhimin financiar/komercial. Kjo pjesë përfundon me vlerësim të performancës së përgjithshme në raport me nivelin ideal të performancës. Një numër i treguesve të performancës janë ilustruar përmes grafikoneve dhe tabelave. Për shumicën e treguesve të performancës, janë dhënë komente të mjaftueshme për të nxjerrë në pah tendencat për performancën mesatare dhe specifike për ofruesit e shërbimeve si dhe arsyet për tendenca të dukshme. Nivelet e treguesve janë diskutuar po ashtu në raport me arritjet e planifikimeve (objektivave) me procesin tarifor.

Pjesa B, Performanca e sektorit të shërbimeve të Ujësjellësit-Kanalizimit, pasqyron performancën e përbashkët të tyre, përmes disa treguesve të rëndësishëm, siç janë: uji i prodhuar, shitjet dhe UPF (uji i pa-faturuar), të hyrat dhe arkëtimi i të ardhurave dhe shpenzimet kapitale. Analiza është bërë për një periudhë 5 vjeçare me qëllim që të japim një pasqyrë më të çartë të trendeve të zhvillimit të këtyre treguesve.

Në vazhdim të raportit **Pjesa C**, është shqyrtuar dhe diskutuar performanca e furnizuesit të vetëm që furnizon me shumicë ujë të patrajtuar (NH Ibër-lepenci). Përderisa me tej në raport në **Pjesën D** raportohet mbi rolin dhe performancën e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve (KKK). Ashtu si në raportet e mëparshme, Raporti Vjetor i Performancës përmban edhe 'temat kyçe', në të cilat përfshihen komentet në lidhje me Zhvillimet në sektor dhe sfidat e ofruesve të shërbimeve të ujit në Kosovë.

Pjesë e raportit janë po ashtu edhe një numër shtojcash të cilat ofrojnë informacione shtesë, të dhëna të detajuara të performancës për secilën KRU si dhe informacione tjera mbështetëse (definicionet dhe arsyeshmërit), pasqyrat financiare, pasqyrat tarifore dhe detajet e kontaktit.

Opinionin ndërkombëtar që më heret, tani me edhe në vendin tonë jemi të bindur me faktin se **UJI** është një nga sfidat më të mëdha të shekullit XXI. Shumë ekspertë të shquar të kësaj fushe kanë kohë që po debatojnë dhe argumentojnë se “Uji po shndërrohet gradualisht në sfidën kryesore për shumë popuj dhe rajone të botës”. Pra uji po bëhet faktor determinues i zhvillimit ekonomik dhe i kualitetit të shëndetit të njerëzve”. Është lajm i mirë se Kosova, tashmë ka filluar me përpilimin e **“Strategjisë së Ujit”**, e cila do të ofrojë, bazë të mirë për shfrytëzimin, mbrojtjen dhe përdorimin e tij. Ne mendojmë se strategjia e ujit duhet të shpallë ujin si **“prioritet strategjik”** dhe ta konsideron si një nga pasuritë më të rëndësishme kombëtare që disponojmë të mbështetur me një seri masash: të përdorimit racional të ujit, nxitjes fiskale e financiarë për futjen e teknologjive që përdorin racionalisht ujin apo rrisin shkallën e përdorimit të drejtë nga konsumatorët shtëpiak dhe jo shtëpiak, të percjellur po ashtu me një paket ligjore të plotë për përdorimin dhe trajtimin e ujit si dhe një sistem dijesh e njohurish të përfshira në programet shkollore e edukuese, që japin gjithë njohuritë e nevojshme për ujin dhe rëndësinë e tij. Viti 2013, po ashtu është karakterizuar me disa zhvillime të rëndësishme në aspektet: Avancimit të kornizës ligjore, ngritjes institucionale si dhe zhvillimit të politikave në sektorin e ujit.

Ligji nr. 04/L-147 për ujërat e Kosovës

Ligji i ri për ujëra, u miratua nga parlamenti i Kosovës në mars të vitit 2013 dhe u nënshkrua nga Presidentja në prill të vitit 2013. Resurset ujore, definohen si pasuri me interes të përgjithshëm me pronësi të Republikës së Kosovës që ruhen e mbrohen me ligj. Me këtë ligj është vendosur korniza e cila siguron zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore, formulimin e procedurave dhe parimeve udhëzuese për shpërndarjen optimale të resurseve ujore, të sigurojë mbrojtjen e resurseve ujore nga ndotja, tej shfrytëzimi dhe keqpërdorimi si dhe të përcaktojë strukturat institucionale për administrimin e resurseve ujore. Me këtë ligj janë parapare të themelohen edhe disa organe dhe njësi të tjera siç janë: Këshilli Ndërmintor për Ujërat, Instituti i Kosovës për Ujëra, Autoriteti i rajonit të pellgjeve lumore. Me qëllim të planifikimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të resurseve ujore është parapar të hartohet edhe dokumenti strategjik për ujërat.

• Themelimi i këshillit ndër-ministrior për ujërat (KNMU)

Në vitet e fundit qasja e Qeverisë së Kosovës ndaj shërbimeve të ujit, ka qenë me proaktive. Që nga themelimi i Task Forcës së Ujit (TFU) në vitin 2008 si një trup vendimmarrës ndërministror me detyrë që të avancojë sektorin e ujit dhe kornizën e politikave dhe strategjive lidhur me planet e veprimit dhe e cila do të shërbente edhe si platformë e koordinimit të përpjekjeve nga ana e palëve vendore dhe ndërkombëtare në zhvillimin e metejmë të sektorit. Në përputhje me ligjin Nr. 04/L-147, për Ujërat e Kosovës, Qeveria e Kosovës ka themeluar Këshillin Ndërmintor për ujërat si pasuese e Task Forcës së Ujërave, si një trup koordinues dhe vendim-marrës që shqyrton çështjet sistemore të ujërave, që merret me harmonizimin e nevojave dhe interesave të ndryshme, si dhe propozon masat për zhvillimin, shfrytëzimin dhe mbrojtjen e rezervave të ujit dhe sistemit ujor të Kosovës". Bazuar në këtë vendim, KNMU është i ankoruar në nivel të Kryeministrit dhe është i përbërë nga 4 ministrat e ministrive të linjës (Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministria për Integritet Evropian). KNMU, siguron koordinimin e përgjithshëm të zhvillimit të sektorit të ujit në vend dhe zbatueshmërinë e kornizës ligjore në këtë sektor.

• Strategjia kombëtare e ujërave të Kosovës (2014-2033)

Në përputhje me kërkesat e Ligjit të Ujërave të Kosovës nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe në bashkëpunim me autoritetet kompetente të administratës shtetërore ka filluar së përgadituri, ‘Strategjia Kombëtare e Ujërave të Republikës së Kosovës’, e vlefshme për periudhën (2014-

2033). Qëllimi i përgjithshëm i kësaj strategjie është, menaxhimi efektiv i ujërave si një element qenësor i zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies sociale të Republikës së Kosovës. Në pajtim me parimin e menaxhimit të integruar të ujërave, strategjia ka qasje të gjerë multisektoriale që përpaket të ngërthejë të gjitha aspektet e rëndësishme të menaxhimit të ujërave në Republikën e Kosovës, duke përfshirë përveç, tjerash edhe shërbimet më ujë të popullsisë dhe ekonomitë në zonat e banuara me: furnizimi më ujë, mbledhja e ujërave të zeza si dhe trajtimi i ujërave të zeza. Me strategji po ashtu janë definuar edhe objektivat strategjike për shfrytëzimin eficient të ujërave, si dhe Qeverisje të drejtë dhe efektive të ujërave.

Menaxhimi periudhës së thatësisë

Nga fundi i vitit 2013 dhe fillimi i këtij viti në vendin tonë ka mbretëruar një thatësi ekstreme e cila ka rezultuar që rezervat ujore (liqenet akumuluese) kanë qenë afërsisht të zbrazura duke lënë me tepër se një gjysmë milioni njerëz kryesisht të regjionit të Prishtinës dhe Gjilanit të përballen me mungesë serioze të ujit. Situata përafërsisht ka qenë e përmasave emergjente, ka pasur shumë pak reshje të shiut e sidomos kanë munguar reshjet e borës. Situata me alarmante duket të ketë qenë në zonën e shërbimit nga KRU 'Prishtina' e cila nuk ka mundur të përballojë furnizimin dhe përpunimin e ujit të pijes në kapacitetet e nevojshëm për zonën e shërbimit. Nivelet e ujit në dy liqenet akumulues (Batllavë dhe Liqeni i Badovcit) kanë pasur nivel shumë të ultë të ujit të akumuluar. Situata përafërsisht e ngjajshme ka qenë edhe në KRU 'Hidromorava', ku Liqeni i Perlepnicsës dhe Burimi 'Guri i Hoxhës', kanë qenë buzë shterrjes totale. Në një situatë të tillë për të ruajtur sa do pak sasitë e mbetura të ujit këto dy kompani ishin të detyruara që të ndërmerrnin masa emergjente. Fillimisht me zvogëlimin e përpunimit të ujit të pijes, pastaj fillimin e reduktimeve shtesë të ujit të pijës. Qeveria e Kosovës (Këshillit Ndërmnistror për Ujërat) me qëllim që të menaxhohet situata e krijuar nga thatësia, ka formuar grup punues për këto dy kompani, të udhëhequr nga Sekretariati i Këshillit dhe në përberje edhe nga përfaqësuesit e Komunave, KRU (Prishtina dhe Hidromorava), NJPM (MZHE), Divizioni për Politika i Departamentit të Ujërave (MMPH), Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (MPB), MBPZH, ZRRUK dhe Komuniteti i donatorëve, Grupi punues ka analizuar situatën dhe ka marrë veprimet dhe aktivitet të cilat janë zbatuar nga institucionet përgjegjëse, dhe të cilat kanë ndihmuar në përballimin e situatës. Në vazhdimësi opinion dhe institucionet kanë qenë të njoftuar si me situatën aktuale ashtu edhe me veprimet të cilat janë duke u ndërmarrë.

Udhëzuesit për menaxhimin e thatësirave në Kompanitë Rajonale të Ujësjellësve

Duke marrë parasysh prognozat e institucioneve ndërkombëtare dhe vendore si dhe regjioni i Ballkanit me të edhe Kosova mund të ndodhet në fushën e ndikimeve të ngrohjes globale me pasoja në ndryshime klimatike gjegjësisht të varacioneve të temperaturave dhe reshjeve. Këshilli Ndërmnistror i Ujërave dhe GIZ-së, (Programit të Adaptimit ndaj Ndryshimeve Klimatike në Ballkanin Perëndimor), ka filluar me përgatitjen e 'Udhëzuesit për Menaxhimin e Thatësirave në Kompanitë Rajonale të Ujësjellësve'. Drafti është përgatitur me ndihmën e konsulencës ndërkombëtare gjatë periudhës Nëntor 2013 – Qershor 2014, duke u bazuar në standardet më të mira Evropiane në këtë fushë, si dhe në konsultim e bashkëpunim të ngushtë me institucionet vendore dhe KRU. KRU 'Hidromorava', është Kompania e parë e cila ka hartuar planin për menagjimin e thatësive. Përgatitja e këtij plani është mbështetur nga Qeveria e Kosovës përmes Këshillit Ndërmnistror të Ujërave me financimin e GIZ-së, programit të adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike në Ballkanin Perëndimor. KRU 'Hidromorava' dhe Plani i saj, do të shërbejë si kompani pilot, me qëllim që çdo KRU në Kosovë t'i mundësojë që ta përmbushë detyrimin e saj ligjor për të hartuar dhe zbatuar një plan efektiv të menaxhimit të thatësirave dhe për të siguruar furnizimin e nevojshëm me ujë për publikun gjatë gjithë kohës.

Programi i adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike në Ballkanin Perëndimor

Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), është duke zhvilluar një program investiv të konsiderueshëm me projekte të përbashkëta me institucionet Qeveritare të vendeve të Ballkanit Perëndimor (Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi, Serbi dhe Kosovë) me qëllim për të përgatitur këto vende që të përballën me efektet negative të ndryshimeve klimatike. Sipas parashikimeve aktuale, Ballkani ka një rrezik në rritje të ngjarjeve ekstreme të motit. Stinat e verës do të bëhen të thata dhe gjithnjë e më të ngrohta, po ashtu edhe dimrat mund të bëhen edhe me të ftohtë. Kjo do të krijojë shumë më tepër probleme në furnizimin me ujë, dhe për këtë në mënyrë specifike programi, ka qëllim të ndihmoj këto vende (Kosovën) për të krijuar një sistem të paralajmërimit të hershëm për përmbytjet dhe thatësitat. Gjithnjë duke tërhequr vëmendjen e politikëbërësve për të orientuar angazhimet e tyre më shumë për furnizimin me ujë, si dhe studime në zhvillimin dhe konzervimin e burimeve ujore.

Programi i ujit për Danubin (IAWD)

Në vitin 2013 ka filluar programi i ujit për Danubinë me mbështetje të Bankës Botërore, në të cilin përfshihet edhe Kosova, krahas 12 shteteve të rajonit të Danubit, (Austria, Shqipëria, Ukraina, Rumania, Moldavia, Bullgaria, Maqedonia, Serbia, Kroacia, Bosnja e Hercegovina dhe Mali i Zi). Ky projekt ka për synim të ju ndihmoj këtyre vendeve në ndërtimin e shërbimeve të forta dhe të qëndrueshme të ujësjellësit dhe shërbimeve të ujërave të zeza. Plani i Punës është strukturuar rreth pesë shtyllave vijuese: Politikat, Tarifat, Benchmarking, Menaxhimi i pasurive dhe planifikimi i investimeve si dhe Përmirësimi i efikasitetit të shërbimit. Programi zbatohet duke përdorur tre instrumente kryesore: punë analitike dhe këshillimore, platformë për ndarjen e njohurive dhe aktiviteteve të zhvillimit të kapaciteteve. Kosova është pjesë aktive e këtyre aktiviteteve me pjesëmarrjen e zyrtarëve përgjegjës nga institucionet e sektorit të ujit.

Vazhdimi i konsolidimit dhe integrimi të ujësjellsëve komunal

Procesi i ristrukturimit (konsolidimit) të ndërmarrjeve publike komunale i filluar në vitin 2003, ndonëse është finalizuar në fund të vitit 2006, ka lënë jashtë, ndërmarrjet komunale në komunat me shumicë serbe (Shtërpçë, Novobërdë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan), mandej komunat e me mëvonshme të krijuara gjatë procesit të decentralizimit dhe dy ndërmarrjeve komunale të ujit në Deqan dhe Kaçanik të cilat me vendim të kuvendit komunal të tyre kanë vendosur të mos jetë pjesë e KRU respektive. Tanimë ndërmarrja e ujësjellësit të Deqanit dhe Kaçanikut janë të integruara, pritet që së shpejti edhe komunat Novo Berdë, Shtërpçë, Ranillug, Partesh dhe Kllokot ti bashkangjiten KRU 'Hidromoravës' respektivisht 'Bifurkacionit', meqenëse është siguruar vullneti i dy anshëm edhe i KRU dhe komunave respektive.

10 VITE TË RREGULLIMIT TË KRU

Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Mbeturina (ZRRUM) si autoritet përgjegjës për rregullimin ekonomik të ndërmarrjeve publike të ujit dhe mbeturinave është themeluar në nëntor të vitit 2004 (përmes Rregullores 2004/49) në kuadër të reformave të ndërmarrja nga institucionet vendore 2003-2008, për të reformuar sektorin e shërbimeve të ujit në vend. Qellim kryesor i instalimit të rregullatives ekonomike përveç tjashe ka qenë edhe krijimi i ndërmarrjeve të qëndrueshme financiarisht, ngritjen e llogaridhënies dhe transparencës, si dhe ngritjen e efikasitetit përmes zbatimit efektiv të mbikëqyrjes rregullatore. Me vonë në vitin 2008 rregullorja 2004/49, është zëvendësuar me Ligjin për Rregullimin e Veprimtarisë së Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit (nr. 03/L-086) i cili ligj përcakton kornizën ligjore për rregullimin ekonomik të kompanive publike që ofrojnë shërbimet e ujësjellësit, kanalizimit në Kosovë si dhe përcakton përgjegjësitë dhe autorizimet e ZRRUK si rregullator i pavarur që i përgjigjet Kuvendit të Kosovës. ZRRUK, sipas këtij ligji, është autoritet përgjegjës për: (i) licencimin e ofruesve të shërbimeve të ujit, (ii) përcaktimin (aprovimin) e tarifave për shërbimet e ujit, (iii) përcaktimin dhe mbikëqyrjen e standardeve të shërbimit, (iv) monitorimin e performancës së ofruesve të shërbimeve, dhe (v) rregullimin e raporteve ndërmjet ofruesve të shërbimeve dhe konsumatorëve.

Si rregullator ekonomik, qëllimi primar i ZRRUK është të siguroj se ofruesit shërbimeve të rregulluara, nuk keqpërdorin pozitën e tyre monopolistike duke siguruar që ata ofrojnë shërbime me standarde të mira, me çmime të arsyeshme dhe se të drejtat dhe obligimet e tyre si dhe të konsumatorëve të tyre balanohen dhe implementohen mirë.

Rregullimi ekonomik i sektorit të ujit nga një rregullator i pavarur është në pajtim me praktika të mira në ndërkombëtare dhe pasqyron këto karakteristika kryesore të këtij sektori:

(i) Organizimi rajonale, d.m.th. bazohet në pellgjet e lumenjve për shpërndarjen e resurseve të ujit, (ii) Karakterit të monopolit natyror, (iii) Krijimit të mundësive të konsiderueshme për përmirësime me anë të ekonomisë së shkallës, (iv) nevoja për investime afatgjata dhe menaxhim të mirë të sektorit, si dhe (v) disponueshmëri të kufizuar me resurse të afta teknike dhe menaxheriale.

Gjate këtyre 10 viteve të funksionimit, Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim ka arritur të faktorizohet tërësisht në sektorin e shërbimeve të ujit dhe është bërë shtylla kryesore e zhvillimit të KRU dhe sektorit të shërbimeve të ujit në përgjithësi.

Në parim, të arriturat e ZRRUK deri më tani në pika të shkurtëra mund të pëmbledhen:

- Përgatitjen dhe nxjerrjen e instrumenteve ligjore, primare dhe sekondare,
- Lëshimin e licencave për ofruesit e shërbimeve të ujit,
- Miratimi i tarifave për ujë,
- Zhvillimi i metodologjisë për përcaktimin e tarifave,
- Hartimi i politikave tarifore,
- Përpilimi i udhëzimeve të kontabilitetit rregullator,
- Zhvillimi i planeve rregullatore të bizneseve për KRU,
- Zhvillimi i raportimit operativ financiar dhe shërbimeve ndaj konsumatorëve (ROFK),
- Plani i monitorimit vjetorë (PMV),
- Pjesëmarrja aktive në rrjetet ndërkombëtare të Bechmarkingut (IBNET, DANUBIS),
- Themelimi dhe funksionalizimi i Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve në 7 regjionet e Kosovës,
- Kompletimi i stafin të nevojshëm të ZRRUK,

- Dizajnimi dhe përditësimi i faqes së internetit,
- Krijimi i raporteve me palët tjera të interesit në vend dhe jasht vendit,
- Organizimi i një varg punëtorish për palët e interesit në sektorin e ujit,
- Përpilimi i dokumenteve të rëndësishme për funksionimin e mbrendeshem të ZRRUK,
- Publikim i raporteve vjetore të performancës,
- Publikim i raporteve të tarifave,
- Hulumtime dhe studime për çështje të ndryshme rregullatore dhe të sektorit të shërbimeve të ujit në përgjithësi.

ZRRUK gjatë e kësaj periudhe ka siguruar mbështetje të donatorëve dhe Agjencioneve zhvillimore (ZNKE, SCO, etj) përmes disa projekteve të rëndësishme.

ZRRUK, gjatë periudhës 2009-2011, ka rishikuar disa nga Rregullat, duke përfshirë Rregullën për Kartën e Konsumatorëve, Rregullën për Shkyçjen nga Shërbimet e Ujit, Rregullën mbi Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve dhe Rregullën për Standardet e Shërbimit, dhe pas konsultimeve statutore me grupet e interesit, janë lëshuar Rregullat e rishikuara dhe të përditësuara.

Në përputhje me praktikën më të mira rregullatore, në fund të vitit 2007, është prezantuar një ndryshim rrënjësor sa i përket mënyrës së përcaktimit të tarifave dhe e njëjta metodologji është aplikuar gjatë periudhës tarifore tre vjeçare 2009-2011. Çasja e tillë e përcaktimit të tarifave shumëvjeçare është përmirësuar edhe më tutje dhe gjatë vitit 2011, ZRRUK, përmes përkrahjes teknike të siguruar nga konsulentët e financuar nga BE dhe menaxhuar nga ZNKE, ka përcaktuar tarifat trevjeçare për shtatë KRU për periudhën 2012 – 2014, sipas metodologjisë së zhvilluar në përputhje me udhëzimet e kontabilitetit rregullator.

Raporti i performancës që nga vitin rishqyrtues 2010 ka analizuar performancën e KRU duke u bazuar në metodologjinë e re të monitorimit të performancës sipas kërkesave rregullatore (Plani i Monitorimit Vjetor) i cili në fokus ka përfitimet për konsumatorin i cili në tersi është në përputhje me metodologjinë e re të përcaktimit të tarifave.

Për më tepër ZRRUK, së bashku me projektet mbështetëse, i ka ndihmuar të gjithë ofruesit e licensuar të shërbimeve në: ngritjen e kapaciteteve të tyre raportuese, përmirësimin e performancës me theks të veçantë në ngritjen e efikasitetit të arkëtimit, zvogëlimin e ujit të pafaturuar dhe rritjen e kujdesit ndaj konsumatorëve.

Pjesa A:

Performanca e Kompanive Rajonale të Ujësjetës-Kanalizimit

3 PERFORMANCA E KRU

3.1 Furnizimi me ujë

Monitorimi i performancës së shërbimeve të ujit përfshirë, fushat kyçe të aspektit operativ financiar dhe në përgjithësi të cilësisë së shërbimit, ZRRUK ka zhvilluar një proces të mirëfillt të monitorimit të performancës, në tërësi i përmbyllur i cili kalon në për 4 faza: (i) Raportimi i të dhënave nga Kompanitë, (ii) verifikimi i tyre nga ana e Rregullatorit, (iii) analiza si dhe (iv) publikimi i rezultateve të vlerësimit të performancës.

Monitorimi është një element thelbësor për rregullimin e mirë të sektorit dhe kompanive të rregulluara duke u bazuar në performancën e tyre dhe i lejon rregullatorit të përcaktojë nëse kushtet e bazuara në performancë gjatë proceseve rregullatore po japin përfitime për publikun.

Vlerësimi i performancës në këtë raport është ndërmarrë për shtatë Kompanitë Rajonale të Ujësjellësëve (KRU), të cilat ofrojnë shërbime të ujësjellësit dhe ujërave të zeza në zonat e tyre përgjegjëse të shërbimit përfshirë KRU: Prishtina, Hidroregjioni Jugor, Hidrodrini, Radoniqi, Mitrovica, Bifurkacioni si dhe Hidromorava. Vlerësimi pasqyron performancën e KRU gjatë vitit 2013, krahasuar me vitin 2012, dhe në raport me planifikimet e planeve të bizneseve rregullatore të dakorduara me rregullatorin gjatë procesit tarifar (2012-2014). Vlerësimi i performancës është bërë përmes treguesve të performancës të aprovuar me Planin e Monitorimit Vjetor (PMV) të zhvilluar nga ZRRUK.

Të dhënat e ofruara nga KRU, janë raportuar në mënyrë të pavarur sipas, sistemit të raportimit mujor dhe vjetor, përderisa ZRRUK ka ndermarre aktivitetin e auditimit që të sigurohet se të dhënat e raportuara janë të sakta dhe të besueshme. Për më tepër zyrtarëve përgjegjes të ofruesve të shërbimeve i'u është dhënë mundësia për të komentuar saktësin e të dhënave të gjetura si dhe arsyet mbi performancën e tyre.

3.1.1 Performanca teknike

Kualiteti i shërbimit të furnizimit me ujë, mundë të matet përmes një numri të madh treguesish, të disponueshmërisë dhe mbulueshmërisë me këtë shërbim, megjithatë cilësia e vërtetë e furnizimit në një masë të madhe, mund ti përshkruhet edhe disa treguesve teknik-operativ, të cilët ne i kemi diskutuar në këtë raport: fillimisht me kualitetin e ujit, presionin në rrjetë të ujësjellësit, shërbyeshmërinë infrastrukturore si dhe vazhdimësin e furnizimit.

Kualiteti i ujit

Sigurimi se uji i ofruar në shërbim është i pijshëm dhe me cilësi të lartë është thelbësor për shëndetin dhe mirëqenien e popullatës. Në këtë aspekt, përgjegjësi kryesore e kompanive të ujit është dhënja e ujë që është i sigurt(i pastër) dhe i këndshëm për tu pirë.

Edhe këtë vit, kualiteti i Ujit është vlerësuar në bazë të rezultateve të raporteve të rregullta mujore nga Qendra e Ujit (IKSHPK) si institucion përgjegjës për monitorimin dhe garantimin se uji i distribuar nga KRU, është i pijshëm dhe në përputhje me vlerat parametrike të kuadrit ligjor², i cili garanton cilësinë e ujit.

Në këtë pjesë, raportohet mbi pajtueshmërinë e ujit të distribuar nga KRU me disa parametra kryesore që tregojnë cilësinë e ujit të pijshëm, nga aspekti Mikrobiologjike dhe Fiziko –Kimik.

² Udhëzimi Administrativ NR. 16/2012, për kualitetin e ujit të pijshëm për konsum nga njeriu, është aprovuar me 24 dhjetor 2012, Në të janë përcaktuar vlerat parametrike (Fiziko-Kimike dhe Mikrobiologjike), që duhet të arrihen për të qene, uji pijeshem nga njeriu.

Niveli i pajtueshmërisë, merr parasysh numrin total të mostrave të analizuar në raport me numrin e mostrave të cilat e kanë përmbushur standardin e cilësisë së ujit të pijshëm. Me rëndësi është të theksohet në këtë rast se një pajtueshmëri e ulët mund të thotë mangësi në kualitetin e ujit.




Figura 1, Rezultatet e testimit të cilësisë së ujit

Pajtueshmëria mikrobiologjike e ujit, është treguesi më i rëndësishëm me një impakt të menjëhershëm në shëndet, pa e neglizhuar në këtë drejtim edhe aspektin kimikë. Përderisa parametrat fizik- ngjyra, shija dhe era janë të rëndësishme për perceptimet e konsumatorëve lidhur me cilësinë estetike.

Sa i përket kualitetit të ujit për nga aspekti bakteriologjik gjatë vitit 2013, është shënuar performancë më e mirë më 98.4% kalueshmëri të testeve në raport me vitin 2012 kur kalueshmëria ishte 97.6%. Impakt në këtë rezultat të përgjithshëm ka pasur performanca e përmirësuar në KRU (Prishtina, Hidroregjioni Jugor dhe Mitrovica). Kompanitë tjera pothuajse kanë pasur performancë të njëjtë në kualitetin e ujit, përjashtuar KRU 'Hidrodrini', e cila ka treguar performancë më të dobët këtë vit me 98.6%, kalueshmëri të testeve bakteriologjike.

Kualitetin e ujit më të mirë për konsumatorët e saj sa i përket aspektit bakteriologjik edhe në vitin 2013 e ka ofruar KRU 'Radoniqi'.

Cilësia bakteriologjike e ujit në të shumtën e rasteve, ka qenë e ndikuar nga prezenca e baktereve koliforme dhe e-coli, prania e të cilave do të thotë se uji mund të jetë i kontaminuar me materiale fekale. Këta mikroorganizma nuk lejohen të jenë të pranishëm në ujë të pijshëm.

Pajtueshmëria fiziko –kimike, e kualiteti të ujit për nga aspekti fiziko-kimik në nivel sektori gjatë vitit 2013, ka shënuar vlerën 97,4% dhe ka mbetur e njëjtë me vitin 2012.

Shkallë me të lartë të dështimit në aspektin fiziko-kimike, gjatë vitit 2013, kanë raportuar dy KRU (Mitrovica dhe Hidroregjioni Jugor).

Dështimi i kualitetit të ujit për nga aspekti fiziko-kimik gjatë vitit 2013, në shkallë më të lartë, është vërejtur tek KRU 'Mitrovica' (Mitrovicë, Skënderaj dhe Vushtrri) në raport me vitin 2012, prezente mbi normat vendore kanë rezultuar parametrat kimik mangani (Mn) dhe Nitritet (NO2).

KRU 'Hidrodrini', ndonëse në vitin 2013 ka shënuar progres, ende ka probleme me prezencën e lartë të ndotjes kimike, kryesisht në zonën e furnizimit nga Nj.O-Klinë.

Monitorimi i brendshëm i cilësisë së ujit në bazë të UA 16/2012, është paraparë të bëhet nga KRU, prandaj ato janë të obliguara të kryejnë analiza të rregullta të cilësisë së ujit për të siguruar se uji furnizuar prej tyre përputhet me Standardet vendore për ujë të pijshëm. Shumica e KRU edhe pse i kanë laboratorët dhe bëjnë disa testime bazike, ato ende nuk janë plotësisht të pajisura me staf dhe aparaturë të nevojshme për ti plotësuar kriteret të cilat dalin nga UA.

ZRRUK, rekomandon KRU që sa më shpejtë të zbatojnë monitorimin e brendshëm të cilësisë së ujit, qoftë përmes laboratorëve të tyre të akredituara apo edhe të kontraktuara për këtë qëllim.

Presioni i ulët i furnizimit

Ky tregues i referohet numrit të përgjithshëm të pronave në një zonë të furnizimit me ujë të cilat kanë marrë ujë me një presion nën nivelin e referencës³, ligjore vendore. Presioni në rrjetë është njëri prej standardeve të rëndësishme të shërbimit, dhe mos arritja e tij, lidhet drejtpërdrejtë me kënaqshmërinë e konsumatorëve me shërbimin e ofruar, duke shkaktuar shqetësim, sidomos gjatë përdorimit të pajiseve sanitare.




Figura 2, % e Konsumatorëve të furnizuar me presion të ultë.

Në nivel sektori gjatë vitit 2013 shihet se nuk kemi pas probleme të mëdha sa i perket presionit të ultë pasi kjo vlerë ka rënë në 2%, nivel edhe më të ultë se sa ishte në vitin 2012 prej 5%.

Duket se dy KRU (Mitrovica dhe Bifurkacioni), ende kanë probleme me sigurimin e presionit në disa zona të shërbimit të tyre. Të dhënat e raportuara tregojnë se këto dy kompani kanë probleme më të mëdha se kompanitë e tjera, ndonëse krahasuar me vitin 2012 edhe në këto dy kompani është shënuar progres. Dy nga KRU (Hidroregjioni Jugor dhe Hidrodrini) nuk kanë raportuar të kenë pasur probleme me presionin e ultë në zonën e tyre të shërbimit.

Problemet me presion të ultë zakonisht kanë zonat e banimit të cilat kanë shtim të vazhdueshëm të popullatës si dhe zonat që ndodhen në kuotat me të larta gjeodezike.

³ Presioni hidraulik në gypin e kyqjes së konsumatorit, duhet të jetë jo më pakë se 25 m.sh.u dhe jo më shumë se 70 m.sh.u.

Presioni në rrjet aktualisht është shumë i vështirë të matet dhe të raportohet nga ofruesit e shërbimeve për shkak të arsyeve të ndryshme teknike, p.sh. topografisë dhe pengesave tjera teknike. Prandaj ne sygjerojmë që këto të dhëna të merren me rezerva për shkak të jo besueshmerisë së plotë, për më tepër edhe për faktin se asnjë nga KRU, nuk bëjnë ndonjë matje adekuate të presioneve. Ne rekomandojmë të gjitha KRU se duhet vendosur, programe të mirëfillta për menaxhim të presioneve në rrjetet e tyre të shërbimit. Menaxhimi i duhur me presion ndikon direkt në mirëmbajtjen e rrjetit kur dihet se një presion i lartë është shkaktari më i madhë i plasjeve të gypave. Po ashtu kontrollimi i presioneve është i rëndësishëm gjatë aktiviteteve të reduktimit të humbjeve të ujit nga rrjeti, meqenëse minimizon potencialin e rrjedhjeve si dhe redukton sasinë e ujit që humbet, pasi të ketë ndodhur rrjedhja.

Vazhdimësia e furnizimit

Vazhdimësia e furnizimit⁴, me ujë është një nga standardet më të rëndësishme të shërbimit i cili ndikon drejtpërdrejtë në jetën dhe mirëqënien e popullatës. Përndryshe furnizimi i rregullt dhe me ujë cilësor është njëra prej sfidave më madhore që sot ka njerëzimi.

Ky tregues jep informacion mbi përqindjen e numrit të konsumatorëve për të cilët furnizimi me ujë është në dispozicion gjatë periudhës raportuese. Vazhdimësia e furnizimit me ujë, është e ndarë në tri grupime: (i) konsumator me 24 orë shërbim në ditë, (ii) konsumatorë me 18-23 orë shërbim në ditë dhe (iii) ato me më pak se 18 orë shërbim në ditë.

Besueshmeria e shërbimit




Figura 3, Vazhdimësia e furnizimit me ujë për vitin 2013

Siç shihet edhe nga Figura 3, në të gjitha KRU ka pasur mungesë të vazhdimësisë së furnizimit të rregullt me ujë. Në nivel të sektorit në vitin 2013, është shënuar përkeqësim në vazhdimësinë me furnizim në raport me vitin 2012, sidomos kjo është vërejtur në pjesën e dytë të vitit 2013 e cila vije, si pasojë e thatësisë për të vazhduar në mënyrë më ekstreme edhe në fillimin e vitit 2014. Në 2013 rreth 40% e popullatës ka qenë e prekur nga reduktimet e ujit.

Edhe gjatë vitit 2013 kompanitë të cilat kanë pasur më pak, aplikim të reduktimeve (për një periudhë të shkurtë gjatë verës), kanë qenë KRU 'Hidrodrini', 'Radoniqi' dhe KRU 'Hidromorava' me 99% të konsumatorëve që kanë furnizim 24 orë me ujë të pijes edhe pse krahasuar me vitin paraprak kanë rënie për 1%.

⁴ Nënkupton reduktimet e ujit të aplikuar nga KRU, në këtë rastë janë përjashtuar ndërprerjet afatshkurta të furnizimit të cilat kanë qenë si pasojë e defekteve apo ndërprerjeve të planifikuara gjatë realizimit të ndonjë aktiviteti të Kompanisë.

KRU 'Hidroregjioni Jugor', është ranguar në pozitën e dytë me 98% furnizim 24 orë për konsumatorët e saj gjatë vitit 2013 e cila krahasuar me vitin 2012 ka mbetë në pozitën e njëjtë, kurse vetëm 2% e konsumatorëve në total kanë pasur furnizim me pak se 18 orë, po aq sa ishin edhe në vitin 2012.

Probleme në furnizim 24 orë/ditë, për konsumatorët e tyre edhe në vitin 2013 kanë vazhduar të kenë tri kompani, KRU 'Prishtina', 'Mitrovica' dhe KRU 'Bifurkacioni'. Përveç KRU 'Prishtina', e cila ka shënuar përkeqësim, krahasuar me vitin 2012, KRU 'Mitrovica' dhe 'Bifurkacioni', kanë shënuar progres drejtë vazhdimësisë së furnizimit me ujë.

Në përgjithësi janë tri arsye të identifikuara të cilat reflektojnë në mungesën e furnizimit me ujë në zonën e shërbimit të KRU: (i) Mungesa e ujit në burime, (ii) Mungesa e kapaciteteve prodhuese si dhe (iii) Humbjet e larta fizike dhe komerciale të ujit.

Përgjegjësi ekskluzive e ofruesit të shërbimeve, përveç tjerash, është përmbushja e kërkesave të konsumatorëve për vazhdimësi në furnizim si dhe menaxhimin e humbjeve të ujit. Furnizimi jo i rregullt ka ndikim në cilësinë e ujit të pijshëm dhe rrjedhimisht me pasoja negative në shëndetin e popullatës, në mjedis, ekonomi dhe kufizime për përdorime të ndryshme. Ndikon po ashtu edhe në nivelin e kënaqshmërisë së konsumatorëve në shërbimin e ofruar. Me qëllim të adresimit të kësaj sfide ZRRUK, rekomandon KRU që krahas zhvillimit të resurseve dhe ngritjes së kapaciteteve prodhuese të ndërmarrin veprime të planifikuara për reduktimin e humbjeve të ujit.

Plasja e gypave

Paraqitet numrin e plasjeve (defekteve) gjatë një viti për 100 km gjatësi të gypave të ujësjellësit, në sistemin e shpërndarjes i cili është nën përgjegjësin e menaxhimit të kompanisë d.m.th, duke përjashtuar gypat shërbimit të kyçjes së konsumatorëve.




Figura 4, Plasjet e gypave të ujësjellësit

Gjatë vitit 2013 numri i defekteve në rrjetin e ujësjellësit për 100 km gjatësi në nivel sektori është raportuar të jetë më i lartë krahasuar me vitin 2012. Në mesatare të sektorit në 2013 janë shënuar 503 defekte për 100 km rrjetë të ujësjellësit, kjo është për 77% më shumë se sa në vitin 2012, ku janë shënuar 284 defekte për 100/km.

Defekte (plasje) të gypave në vitin 2013, më shume kanë ndodhur në KRU 'Hidromorava' me 1,745 defekte për 100 km, gjatësi të rrjetit të ujësjellësit, kryesisht si pasojë e vjetërsisë së gypave të cilët ende janë në shërbim si dhe presionit jo adekuat ekzistues.

Më pak, defekte gjatë vitit 2013 krahasuar me vitin 2012, janë shënuar në KRU 'Mitrovica', 'Prishtina' dhe KRU 'Hidrodrini'. Kjo ka ardhur para së gjithash, si rezultat i aktiviteteve të këtyre kompanive në rehabilitimin e rrjetit, përmes projekteve aktuale të cilat janë në realizim e sipër.

Ndihmesë në detektimin e rrjedhjeve kanë dhënë edhe qytetarët, përmes adresimit të shumë ankesave (lajmërimeve), tek kompanitë e tyre respektive.

Ndikim të drejtpërdrejtë në performancën e rrjetit kanë: vjetërsia e gypave të ujësjellësit si dhe mos menaxhimi i presionit të lartë. Presioni i lartë është shkatërrues gjatë momenteve, kur konsumi i ujit është më i vogël në zonat me kuotat e ulëta gjeografike. Norma e evidentuar tek të gjitha KRU, tregon se rrjeti distribuiv i KRU, ka probleme të mëdha. Sipas disa standardeve ndërkombëtare për vlerë me të lartë se 50 defekte(plasje) për 100 km të rrjetit të gypave, është i nevojshëm, intervenim urgjent për rehabilitimin e sistemit të gypave. Pa dyshim se ky nivel i lartë i evidentuar i defekteve në rrjetin e distribuimit në të gjitha KRU, ndikon nevojën për investime urgjente në përtërirjen dhe mirëmbajtjen e tyre.

Uji i pa-faturuar (UPF)

Uji i pa-faturuar (sasi absolute), paraqet diferencën mes sasisë së ujit të prodhuar dhe sasisë së ujit të shitur. Në përgjithësi Uji i pa-faturuar përbëhet nga dy komponentë: (i) Humbje Komerciale dhe (ii) Humbje Fizike. Përderisa, humbjet komerciale paraqesin ujin e konsumuar, por që nuk ka arritur të ju faturohet konsumatorëve, pra është uji i shfrytëzuar përmes lidhjeve ilegale, nënvlerësimit gjatë faturimit të pamatur (paushall), konsumit të paautorizuar apo edhe pasaktësisë së ujëmatësëve. Humbjet fizike, janë humbje të cilat ndodhin si pasojë e rrjedhjeve në gypat e shpërndarjes dhe në kyçje, deri te ujëmatësi i konsumatorit.

Vëllimi i UPF (m³/vit)




Figura 5, Uji i pa-faturuar (sasi absolute)

Siç shihet nga figura 5, janë gjashtë kompani, duke përjashtuar KRU 'Hidrodrinin', të cilat kanë trende pozitive në reduktimin e humbjeve sasiore të ujit në vitin 2013 në raport me vitin 2012.

Në nivel sektori humbjet në vlerë sasiore gjatë vitit 2013 në raport me vitin paraprak janë zvogëluar mbi 3.8 milion m³, e ardhur kryesisht si rezultat i zvogëlimit të prodhimit të ujit tek shumica e kompanive. Prodhimi në mesatare të sektorit është më i ultë me mbi 3.6 milion m³, gjatë vitit 2013 në raport me vitin paraprak.

Nga të gjitha kompanitë gjatë vitit 2013 në total janë planifikuar të prodhohen mbi 150 milion m³, të nevojshme për të mbuluar kërkesat e konsumatorëve, përderisa prodhimi aktual ka arritur në vlerën mbi

134 milion m³, kjo është për 11% me pak se planifikimet dhe 3% me pak se në vitin 2012. Zvogëlimi i prodhimit është për shkak të mungesës dhe menaxhimit me rezerva ujore në burime të ndikuara nga mungesa e reshjeve.

Kompania tek e cila UPF, në vlerë sasiore ka shënuar rritje gjatë vitit 2013 në raport me vitin 2012 me mbi 2.4 milion m³ është KRU 'Hidrodrini', kryesisht për shkak të rënies së faturimit për 1 milion m³.

Uji i pa-faturuar (l/kons./d) i rregulluar, paraqet volumin mesatar të UPF në raport me totalin e konsumatorëve në zonën e shërbimit. Ky tregues është rregulluar për orët e furnizimit me ujë (vazhdimësinë e furnizimit), për të amortizuar ndikimin e reduktimeve të furnizimi me ujë i aplikuar nga disa KRU.

Ky tregues ka për qëllim të vlerësojë shumën e humbjeve të përditshme të ujit në raport me numrin e konsumatorëve të ujit, e vlefshme për të bërë analizë gjatë vlerësimit të humbjeve komerciale të ujit.




Figura 6, Performanca krahasuese për UPF, paraqitur (l/kons./d) dhe si (%)⁵

Figura 6, jep prezantim grafik të humbjeve të ujit për kyçe në ditë për ndërmarrjet e ujësjellësit gjatë dy viteve të fundit, (2012-2013).

UPF litër për konsumatorë në ditë (l/kons./d), si mesatare e sektorit gjatë vitit 2013 ka shënuar progres krahasuar me vitin 2012, kjo vërehet edhe nga figura 6, ku të gjitha kompanitë në perjashtim të KRU 'Hidrodrinit' kanë shënuar zvogëlim të humbjeve (l/kons/d).

Kompania e cila është ranguar më së miri sa i përket UPF litër për kyçe në ditë i rregulluar për orët e furnizimit me ujë është KRU 'Hidromorava', me humbjet më të vogla në vitin 2013 prej 544 l/kons/d dhe e cila nëse krahasohet me vitin paraprak sa ishte 649 l/kons/d poashtu ka shënuar progres.

Kompania e cila është ranguar e fundit edhe për vitin 2013, është KRU 'Hidrodrini' të cilën nëse e krahasojme me vitin paraprak ka pas rritje të UPF nga 1,463 l/kons/d sa ishte në vitin 2012 në 1,581 l/kons/d gjatë vitit 2013, edhe përkunder furnizimit të mirë me ujë të pijës që kjo kompani ofron për konsumatorët e saj, humbjet e larta e kanë pozicionuar në vendin e fundit.

Kompania e cila ka shënuar progresin më të madh gjatë vitit 2013 në raport me vitin 2012 tek UPF e shprehur në përqindje është KRU 'Radoniqi' me 8 % zvogëlim të humbjeve. Ndikim në zvogëlimin e UPF tek KRU 'Radoniqi' ka pas ngritja e faturimit në m³ për rreth 1 milion m³/vit gjatë vitit 2013 krahasuar me vitin 2012. Megjithatë, gjatë periudhës raportuese, kjo kompani ka bërë përpjekje për të

⁵ Vlera e UPF për kyçe në ditë është përshtatur/rregulluar që të kompensojë orët e shërbimit në ditë.

përmirësuar situatën dhe është ranguar si kompania, me përmirësimin me të lartë të humbjeve shprehur në përqindje nga të gjithë KRU e tjera.

UPF si përqindje e prodhimit të ujit (%), Në këtë seksion UPF është vlerësuar si përqindje e sasisë së ujit të shitur në raport me sasinë e ujit të prodhuar.

Pra, është treguesi më i zakonshëm që përdoret për të vlerësuar nivelin e humbjeve të ujit. Edhe pse është i lehtë për tu kuptuar dhe është duke u përdorur gjerësisht, egziston një perceptim i përgjithshëm se ky nuk është një tregues më i përshtatshëm për vlerësimin e nivelit të humbjeve të ujit.

Humbjet e ujit shprehur në përqindje në nivel sektori kanë shënuar progres gjatë vitit 2013 dhe janë në nivelin 57% në raport me vitin 2012 sa ishin 58%.

UPF me normën prej 57% në përgjithësi, është ende shumë i lartë, krahasuar praktikisht e mira ndërkombëtare që sillen në lartësinë prej 20%. Në disa vende me sistem të zhvilluar të furnizimit me ujë kjo vlerë arrin edhe nën 10%.

Kompania e cila ka shënuar progresin më të madh gjatë vitit 2013 në raport me vitin 2012 tek UPF e shprehur në përqindje është KRU 'Radoniqi' me 8 % zvogëlim të humbjeve. Ndikim në zvogëlimin e UPF tek KRU 'Radoniqi' ka pas ngritja e faturimit në m3 për rreth 1 milion m3/vit gjatë vitit 2013 krahasuar me vitin 2012. Megjithatë, gjatë periudhës raportuese, kjo kompani ka bërë përpjekje për të përmirësuar situatën dhe është ranguar si kompania, me përmirësimin me të lartë të humbjeve shprehur në përqindje nga të gjithë KRU e tjera.

UPF më të lartë nga të gjitha KRU e tjera gjatë periudhës raportuese 2013 me vlerë prej 72% është raportuar nga KRU 'Hidrodrini', e cila shpjegohet të jetë për shkak të mos menaxhimit të prodhimit të ujit dhe njëkohësisht për shkak të mos efikasitetit të faturimit të ujit të distribuar tek konsumatorët e saj.

Reduktimi i UPF vazhdon të jetë një sfidë për të gjitha KRU. Niveli mesatar i UPF për shtatë KRU shkon deri në masën 57%. Po thuajse asnjë nga KRU nuk kanë qenë në gjendje që të arrijnë objektivin për dy vitet e procesit aktual tarifor. Ne rekomandojmë KRU që përmes veprimeve të planifikuara të qasën problemit të reduktimit të UPF. Fillimisht me koncentrim në reduktimin e humbjeve komerciale e cila është një fushë me potencialin më të madh të reduktimeve dhe njëkohësisht me një kosto të ultë, pa i anashkaluar reduktimin e humbjeve fizike të cilat konsiderohen se kanë një kosto shumë herë më të lartë.

3.1.2 Performanca komerciale

Në vazhdim të këtij raporti janë analizuar dhe diskutuar me gjerësisht tre tregues të rëndësishëm të cilët paraqesin performancën komerciale të KRU.

Mbulueshmëria me shërbime të ujit

Paraqet përqindjen e popullatës brenda zonës së përkufizuar të ofruesve të shërbimeve për furnizim që kanë qasje në shërbimet publike të ujit. Siç shihet, një pjesë e madhe rreth 20% e popullatës (sidomos zonat rurale) aktualisht nuk shërbehen nga ofruesit e shërbimeve publike por kanë, furnizim të kufizuar rural të ujit p.sh. puse apo burime jashtë përgjegjësi të KRU.

Mbulimi me shërbime të ujit është diskutuar në aspektin e popullsisë së shërbyer drejtpërdrejtë me ujë dhe totalit të popullsisë që jeton në zonë të shërbimit të KRU, gjatë periudhës raportuese. Analiza e shërbimit të mbulimit merr parasysh rezultatet e regjistrimit të popullsisë dhe ekonomive familjare që u zhvillua në vitin 2011 dhe botuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.




Figura 7, Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit

Shkallën më të lartë të mbulueshmërisë me shërbime të ujit edhe gjatë vitit 2013, e ka KRU 'Radoniqi' e cila nëse krahasohet me vitin 2012 ka shënuar progres nga 96.2% në 99.7%, kjo ka ndodhë për arsye të shtimit të numrit të ekonomive familjare për një pjesë të regjionit të Prizrenit, e cila është nën menaxhimin e KRU 'Radoniqi'.

KRU 'Hidrodrini', ka raportuar një rënie në përqindjen e popullsisë shërbyer direkt me ujë nga 94.2 % raportuan në 2012 në 90.8%, për gjatë periudhës raportuese. Kjo rënie e mbulueshmërisë, mund të shpjegohet se rënie e shkaktuar kryesisht nga ndikim i zgjerimit të zonës së shërbimit edhe në Komunën e Deçanit e ndodhur me rastin e ri integritit të Nj. O të Deçanit në kuadër të KRU 'Hidrodrini'.

Si mesatare e sektorit, mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit gjatë vitit 2013 arrin në shkallën 81.5% krahasuar me vitin 2012 sa ishte 81.5%.

Rritje më e madhe në këtë tregues gjatë vitit 2013 është raportuar nga KRU 'Hidromorava' dhe 'Prishtina', respektivisht nga 57.2% në 62.7% për KRU 'Hidromorava', dhe 91.3% në 96.4% për KRU 'Prishtina'. Arsyeja kryesore për këto rritje ka qenë implementimi i projekteve të tyre që përfshijnë zgjerimin e rrjetit të shpërndarjes së ujit në zonat e pambuluara me shërbime.

Objektiva e përgjithshme e planifikuar për rritjen e mbulueshmërisë me shërbime nga KRU gjatë vitit 2013 të projektuara me proces tarifar pothuajse janë përmbushur, për faktin se numri i konsumatorëve të rinjë të kyçur në shërbimet e furnizimit me ujë nga KRU, është vetëm për 290 konsumatorë më pak se

planifikimi. Po ashtu janë tri KRU (Hidroregjion Jugor, Hidrodrini dhe Hidromorava) të cilat kanë arritur ti kalojnë objektivat e planifikuara për vitin 2013 për rritjen e bazës së tyre të konsumatorëve.

Një përmirësim i dukshëm dhe kardinal është rritja e numrit të popullatë me çasje në furnizim me ujë. Gjendja aktuale e mbulueshmërisë me shërbime të ujësjellësit, ofron një pasqyrë ekzistuese me potencial që KRU të rrisin bazën e tyre të konsumatorëve. Nga Figura 7, mund të vërehet se asnjë nga KRU nuk kanë qenë në gjendje të ju ofrojnë shërbime me ujësjellës të gjithë popullësisë që jetojnë në zonat e tyre të shërbimit. Shumica e KRU e sidomos KRU (Hidromorava, Hidroregjioni Jugor dhe Mitrovica) kanë potencial më të madhë të rritjes së bazës së tyre të konsumatorëve. Prandaj ZRRUK sygjeronë KRU që të bëjnë sa më shpejtë integrimin e komunave dhe skemave rurale të ujësjellësëve, meqenëse këtë e shofim si të rëndësishëm për KRU si mundësi e realizimit të të ardhurave shtesë, por njëkohësisht edhe të rëndësishëm për vetë popullatën meqenëse do të marrin shërbime me të qëndrueshme dhe të sigurta. Kompanitë duhet të evidentojnë edhe kyçjet ilegale dhe të bëjnë legalizimin e tyre, meqenëse nga Biznes planet e KRU kemi parë se ato gjithashtu ilustronë një potencial të lartë të rritjes së numrit të konsumatorëve dhe të shitjeve. Kjo për më tepër do të sigurojë mundësi për rritje të shitjeve pa rritje proporcionale të kapacitetit prodhues si dhe do të kontribuojë në reduktimin e UPF.

Matja e ujit

Ujëmatja është e nevojshme në mënyrë që të matet sasinë e ujit të konsumuar, si dhe për të ngarkuar konsumatorët me konsumin e tyre real. Për më tepër është një mjet i rëndësishëm i një kompani për të monitoruar sasinë e ujit të prodhuar dhe të shitur.




Figura 8, Proporcioni i konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës

Në figurën 8, është paraqitur proporcioni i konsumatorëve shtëpiak të cilët janë pajisur me ujëmatës në raport me totalin e konsumatorëve shtëpiak të shërbyer.

Gjatë vitit 2013 në nivel të sektorit raporti mesatar i matjes se ujit ka vazhduar të përmirësohet dhe arrin në 91%, kjo është për 2% më shumë se në vitin paraprak 2012. Në terma absolutë gjatë vitit 2013 janë raportuar të jenë vendosur mbi 5,000 ujëmatës të rinj nga të gjitha kompanitë vetëm për kategorinë e amvisërisë.

Proporcioni me ujëmatës i konsumatorëve komercial- industrial dhe atyre institucional është në nivelin 94%.

Në vitin 2013 KRU 'Hidrodrini' dhe 'Radoniqi', kanë pajisur konsumatorët e tyre me ujëmatës në nivelin 95% ndërsa 96% KRU 'Hidroregjioni Jugor'. Përderisa KRU 'Mitrovica', ende faturon vetëm rreth 59% nga numri total i konsumatorëve bazuar në leximin e ujëmatësve.

Përmirësim të ndjeshme në proporcion të konsumatorëve me ujëmatës është vërejtur në KRU 'Bifurkacioni' me normën në rritje prej 5%, në raport me vitin 2012. Përderisa proporcionin më të lartë të konsumatorëve me ujëmatës gjatë vitit 2013 e ka KRU 'Prishtina' me 97%.

Duhet të theksohet se rritja e ngadaltë e shkallës së proporcionit të konsumatorëve me ujëmatës, ndikohet edhe nga nevoja për të zëvendësuar ujëmatësit e dëmtuar dhe jo funksional të cilët po ashtu janë me një masë të konsiderueshme në të gjitha KRU.

Një nga objektivat e ZRRUK, gjatë dy viteve të fundit ka qenë që kompanitë, të paisin të gjithë konsumatorët e tyre me ujëmatës funksional dhe të kalibruar duke pasur si qëllim, eliminimin e faturimit të vlerësuar (paushall) dhe ngritjen e saktësisë së faturimit në përgjithësi.

Brenga e rregullatorit është e lidhur me shqetësimet e një numri të madh të konsumatorëve nga qytete të ndryshme të cilët adresojnë ankesat e tyre tek kompanitë por edhe të Rregullatori, në lidhje me faturat e fryra të ujit. ZRRUK rekomandon KRU që pajisjen e konsumatorëve me ujëmatës ta vendosin si prioritet jo vetëm për faktin se konsumi i matur ka efekte pozitive në shumë aspekte por edhe të përmbushin kërkesën ligjore e cila i obligon që faturimi të bëhet vetëm përmes leximit të ujëmatësve. Për me tepër ky është po ashtu një mjet i domosdoshëm për të menaxhuar në mënyrë efikase për kursimin e ujit, kjo fiton peshë më të madhe sidomos tek KRU të cilat përballen me sfidën e përmbushjes së nevojave të popullsisë së tyre me ujë të pijshëm.

Ankesat

Në këtë pjesë të raportit paraqitet numri i përgjithshëm i ankesave të pranura nga ana e KRU, të cilat janë parashtruar në mënyrë të shkruar apo gojore nga ana e konsumatorëve me ç'rast ata kanë shprehur pakënaqësinë në lidhje me ndonjë veprim jo të drejtë apo mos veprim nga ana e kompanisë. Ankesat e konsumatorëve japin një pasqyrë të rëndësishme të kënaqësisë së përgjithshme të konsumatorëve me shërbimet e ofruara nga kompanitë e ujit. Ankesat e konsumatorëve po ashtu janë të një rëndësie të veçantë, meqenëse sigurojnë informacione në lidhje me aspekte të performancës që kanë nevojë për përmirësim.




Figura 9, Ankesat në shërbimin e ujësjellësit

Korniza e raportimit të performancës kërkon nga kompanitë që të raportojnë, numrin total të ankesave të konsumatorëve të specifikuar në dy kategori: (i) Ankesat teknike, të cilat kanë të bëjnë me

furnizimin jo të rregullt, ndërprerjeve dhe defekteve të shpeshta në rrjetë si dhe kualitetin e ujit të pijes dhe (ii) Ankesa komerciale të cilat me shumë, janë për shkakun e kontestimit të saktësisë së faturimit dhe mënyrës së faturimit (faturimi paushall dhe faturimi në banesa kolektive,etj).

Numri i ankesave për shërbimet e ujit gjatë vitit 2013 në total arrin vlerën 18,211, kjo është për 24% më e lartë në vitin 2013 në raport me 2012. Prej tyre 12,361 apo 68%, janë ankesa të natyrës teknike dhe ato shumica janë të lidhura direkt me rrjedhjet e ujit në rrjetin e ujësjellësit, ndërsa 5,850 apo 32%, janë ankesa komerciale që kanë të bëjnë me kontestimet e borxhit dhe ndërprerjet e faturimit.

KRU 'Bifurkacioni' ka raportuar numrin më të vogël me gjithsejt 222 ankesa duke vazhduar nga KRU 'Radoniqi', me 365 ankesa në 2013. KRU 'Prishtina' dhe Radoniqi' janë dy kompani për dallim nga të tjerat që kanë raportuar rënje tek numri i ankesave në vitin 2013/2012.

KRU 'Mitrovica' dhe 'Bifurkacioni', kanë raportuar numër në ngritje të ankesave dhe kjo është para se gjithash për shkak të menaxhimit më të mirë të ankesave në këtë vit.

Rritja e numrit të ankesave teknike të cilat kryesisht lidhen me rrjedhje në rrjetin e ujësjellësit na ofron një pasqyrë të gjendjes në të cilën ndodhet, rrjeti i furnizimit me ujë në të gjitha KRU. Këto të dhëna japin një indikacion të çartë se Kompanitë e ujit duhet të marrin masa për investime urgjente me qëllim të rehabilitimit të tyre.

Rritja e numrit të ankesave në vazhdimësi vit pas viti është edhe për shkakun se konsumatorët kanë filluar të vetëdijësohen dhe të binden se ja vlen për tu ankuar, meqenëse shumica e kompanive gjithnjë e më shumë janë të përkushtuara për ti shqyrtuar dhe azhurnuar në mënyrë sa më të rregullt dhe të shpejtë ankesat e adresuara nga konsumatorët.

Rregulla për standardet minimale të shërbimit e vendosur nga rregullatori, ka përcaktuar detyrime për ndërmarrjet e ujit në lidhje me përgjegjshmërinë dhe trajtimin e ankesave të shërbimit. Në përputhje me kërkesat ligjore dhe praktikën e mira, KRU duhet të kenë të shkruara, procedurat për trajtimin e ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve, sistem të përshtatshëm për regjistrimin dhe përditësimin e të dhënave, si dhe mundësi për vlerësimin e progresit gjatë shqyrtimit të ankesës. Konsumatorëve po ashtu kompanitë duhet ti sigurojnë trajtim dhe shqyrtim të ankesave në përputhje me afatet ligjore të përcaktuara me standarde të shërbimit.

Volumi i ujit të shitur

Paraqet volumin e ujit të shitur në raport me projeksionet në Planet e Bizneseve të aplikuara për procesin tarifar aktual (2012-2014).




Figura 10, Shitjet e ujit në raport me shitjet e planifikuara gjatë rishikimit tarifar (2012-2014)

Në nivel sektori shitjet e realizuara në raport me ato të planifikuara, kanë shënuar performancë më të dobët për 3%. Në vitin 2013 realizimi i planifikimeve në nivel sektorit ishte 89%, nëse kjo kthehet në vlera sasiore për vitin 2013 nga të gjitha KRU janë planifikuar të shiten mbi 60 milion m³ ujë, përderisa janë realizuar, rreth 53 milion m³, që është me pak për mbi 6 milion m³.

KRU 'Radoniqi', 'Hidromorava' dhe KRU 'Hidroregjioni Jugor', janë tri kompani rajonale të cilat kanë arritur të realizojnë shitjet e planifikuara, përderisa kompanitë tjera duke përfshirë KRU 'Prishtinën', 'Hidrodrinin', 'Mitrovicën' dhe KRU 'Bifurkacionin', kapin vlerat ndërmjet 70% dhe 90%, të përmbushjes së caceve të planifikuara në shitjet volumetrike të ujit.

KRU 'Bifurkacioni', gjatë vitit 2013 sikurse në vitin 2012 ka qenë më së largu në përmbushjen e synimit të shitjeve të ujit me vetëm 79%.

Mos arritja e objektivave të shitjet sasiore (volumetrike) të ujit ka shkaktuar që shumica e KRU mos të kenë të ardhura të planifikuara për të përmbushur nevojat e tyre financiare. Kjo është reflektuar edhe në mosrealizimin e projeksioneve të shpenzimeve kapitale.

3.1.3 Performanca Financiare

Vlera e shitjeve (EUR)

Vlera totale e shitjeve të ujit është një tregues i rëndësishëm i performancës financiare përmes të cilës mbulohen shpenzimet operative dhe mirëmbajtja kapitale duke krijuar parakushte për vetë qëndrueshmërinë financiare të kompanive.

Figura si më poshtë paraqet performancën e shitjeve të ujit në krahasim me vlerësimet e planifikuara ashtu siç ishin të përcaktuara në aplikacionet tarifore të KRU për procesin e rishikimit tarifar 2012-2014.




Figura 11, Vlera e shitjeve të furnizimit me ujë në raport me shitjet e planifikuara

Pa ndonjë befasi edhe këtë vit sikur edhe vitet e kaluara vlera e shitjeve për çdo KRU ishin shumë me të ulëta se sa vlera e planifikuar e shitjeve (shih Figura 11 -), dhe atë kryesisht për shkak të realizimit të dobët të volumeve të shitjeve siç është përshkruar më sipër.

Vlera e shitjeve e realizuar për vitin 2013 në nivel të sektorit për furnizim me ujë, ishte 25,780,769€ ndërsa ajo e planifikuar 31,355,141€ do të thotë se 82% e shitjeve janë realizuar nga ajo që ishte planifikuar dhe është me e ultë për 6% krahasuar vitin 2012. (Vlera e planifikimit për vitin 2012 ka qenë 28,717,893€, përderisa është realizuar 25,190,720€ apo 88%).

Planifikimet në vlerën e shitjeve, natyrshëm janë në rritje vit pas viti nga KRU. Për vitin 2013 pritjet për shitje kanë qenë më të larta për 9% në raport me vitin 2012. Vlera e shitjeve të realizuara është rritur vetëm për 2%, në vitin 2013/2012. Kjo para së gjithash është rezultat i jo efikasitetit të KRU për ti rritur shitjet sasiore, por një pjesë mund ti atribuohet edhe zvogëlimit të prodhimit i cili në vitin e shqyrtuar ka qenë me i ultë për 3% , se sa në vitin paraprak 2012.

Performanca e shitjeve në nivel të kompanive, rastin me të mirë është ajo e KRU ‘Radoniqi’ me përqindjen me të lartë të caktit të arritur. Po ashtu arritja e planifikimeve nga kjo kompani është më mirë për 3 % krahasuar me vitin 2012.

KRU ‘Mitrovica’ si rast me i keq, ka arritur vetëm 73% të caktit të synuar. Për më tepër performanca e kësaj kompanie në këtë tregues është me e ultë për 7% nga viti paraprak 2012.

Vlera e shitjeve relative e të furnizimit me ujë

Pasqyron trendet e vlerës së shitjeve të realizuara gjatë periudhës raportuese 2013 në raport me vitin 2012.




Figura 12, Vlera e shitjeve të furnizimit me ujë gjatë 2013 në raport me vitin 2012

Nga figura më lartë, vërehet se në katër nga shtatë KRU, është shënuar progres në këtë tregues gjatë vitit 2013 krahasuar me vitin 2012. Njëjtë sikur vitin e kaluar prin KRU ‘Bifurkacioni’, me shitjet me të larta për rreth 12.02%, si rezultat i rritjes së shitjeve volumetrike, reflektuar nga rritja e numrit të konsumatorëve për 8% krahasuar me vitin paraprak.

KRU ‘Prishtina’, ‘Hidrodrini’, dhe ‘Mitrovica’⁶, janë kompanitë të cilat kanë shënuar rënje në vitin 2013 krahasuar me vitin 2012 rezultat i të cilës ka qenë zvogëlimi i shitjeve volumetrike edhe pse pritjet kanë qenë me të larta në përputhje me rritjen e bazës së konsumatorëve.

Në vlerë absolute, shitjet në 2013 në raport me vitin 2012, janë më të larta për 2.34% në nivel të sektorit.

Kostoja e Prodhimit

Kostoja për njësi e ujit të prodhuar është tregues po ashtu i rëndësishëm financiar në bazë të cilës, vlerësohen shpenzimet për një m³ të ujit të prodhuar.

⁶ Te KRU “Mitrovica”, nuk është i përfshirë faturimi për Pjesën Veriore.




Figura 13, Kostoja për njësi e ujit të prodhuar gjatë 2012 në raport me vitin 2011

Në nivel të sektorit, kostoja mesatare e një njësie uji të prodhuar në 2013 nuk ka pësuar ndryshim krahasuar me vitin 2012, ka mbet e njëjte me 0.04 €/m³.

Kostot e prodhimit të ujit me e ulëta, sillet nga 0.004 €/m³ tek KRU 'Hidrodrini' deri tek ajo më e larta në 0.08 €/m³ në KRU 'Hidroregjioni Jugor'. Kostoja e prodhimit në përgjithësi është e varur prej llojit të sistemit (me gravitet apo me pompim) si dhe nivelit të trajtimit.

Kostoja e lartë e ujit të prodhuar të KRU 'Hidroregjioni Jugor' edhe këtë vit është ndikuar nga shpenzimet e larta për trajtimin e ujit në veçanti nga shpenzimet e energjisë dhe derivateve gjatë funksionimit të pompave.

Kostoja totale për njësi e furnizimit me ujë

Paraqet koston totale duke përfshirë shpenzimet operative dhe shpenzimet për mirëmbajtje kapitale të aktivitetit biznesor për furnizim me ujë në raport me volumin e ujit të shitur për të njëjtën periudhë raportuese.




Figura 14, Kostoja për njësi të furnizimit me ujë (duke përjashtuar kthimin në kapital dhe borxhet e këqija)

Kostoja për njësi e furnizimit me ujë në nivel të sektorit në vitin 2013 krahasuar me vitin 2012 ka qenë me e lartë për 0.02⁷ EUR/m3.

Siç vërehet edhe nga figura me lartë ekziston një amplitudë e gjerë sa i përket kostos totale për njësi për furnizimin me ujë, që nga Hidrodrini i cili ka nivel dukshëm më të ulët të kostos se të gjitha kompanitë tjera të ujit me 0.21 €/m3, deri tek ajo më e larta për KRU 'Prishtina' me 0,41 € për m3 të ujit të shitur dhe të paguar.

Kostot në vitin 2013 raport me vitin paraprak 2012, përveç tek KRU 'Radoniqi' dhe KRU 'Hidromorava', kanë treguar trende pozitive në rënje prej 0.01€, KRU 'Radoniqi' përkatësisht me 0.06 KRU 'Hidromorava', tek të gjitha kompanitë tjera janë shënuar trende negative të kostove.

Rritja e kostove për njësi të ujit të furnizuar mund t'i atribuohet zvogëlimit të shitjeve volumetrike, dhe rritjeve të dukshme të shpenzimeve totale operative të shërbimeve të ujit.

Kostoja totale për njësi e furnizimit me ujë e realizuar ne raport me atë të planifikuar

Kostoja totale për njësi e furnizimit me ujë është një tregues financiar i cili radhitet në grupin e treguesve kryesor ne bazë të cilëve edhe matet performanca e furnizimit me ujë.

Treguesi i paraqitur grafikisht si me poshtë paraqet raportin në mes kostos për njësi të furnizimit me ujë të realizuar (shpenzimet operative duke përfshirë mirëmbajtjen kapitale/faturimin m3) dhe kostos për njësi te furnizimit me ujë të planifikuar (shpenzimet operative duke përfshirë mirëmbajtjen kapitale/faturimin ne m3).




Figura 15, Kostoja për njësi e furnizimit me ujë ne raport me kostot e planifikuara për njësi

KRU 'Bifurkacioni' edhe pse ka arritur koston me të lartë të planifikimit për vitin 2013 duke i tejkaluar ato për 25%, prapë nuk tregon efikasitet me të madhe se sa ishte planifikuar, për arsye se kostot e planifikuara për njësi kanë përfshirë shpenzime të konsiderueshme për ripërtëritje infrastrukturore dhe zhvlerësimin sipas kostos aktuale për asetet e reja e që nuk ka ndodhur ti realizojë ato as 40% të tyre. Për më tepër shpenzimet operative në kete kompani janë tejkaluar për 8% përderisa edhe faturimin në m³ i planifikuar ka arritur të realizohet vetëm 79%.

Në nivel të sektorit caku i arritur i kostos për njësi e furnizimit me ujë ka qenë 109%, dhe ka qenë me i lartë për 5%, krahasuar me vitin paraprak. Në këtë ka ndikuar rritja e shpenzimeve operative si dhe atyre për mirëmbajtje kapitale. Vlen të përmendet si rasti me i mirë ai në KRU 'Hidroregjioni Jugor', e

⁷ Kostoja për njësi e vitit 2012 është e rregulluar me normën e inflacionit 1.017626

cila ka arritur që ti realizoj shpenzimet për mirëmbajtjen kapitale në nivelin 193%, nga ato të cilat i kishte planifikuar.

Ajo se çfarë nënkuptohet me këtë është se edhe pse kostot për njësi në nivel të sektorit ishin më të larta se sa ishin planifikuar, me tepër ka pasur rritje të shpenzimeve operative në raport me rritjen e shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale, dhe e cila ka rezultuar me përkeqësimin e gjendjes së aseteve dhe rënien e nivelit të shërbimit.

Ne jemi fuqimisht të mendimit se këto shpenzime operative janë joefikase me personel të shumtë në shumicën e ndoshta edhe në të gjitha KRU. Në procesin e caktimit të tarifave shpenzimet operative kanë qenë të sfiduara në bazë të krahasimit të propozimeve (benchmarking). Për këtë arsye ne kemi bërë rregullimet e propozimeve të shpenzimeve operative duke arritur një reduktim vjetor 12%, në shpenzimet operative. Sidomos kemi kërkuar që eficienta operative të bëhet përmes reduktimit të shpenzimeve në personel të KRU por edhe në disa fusha të tjera. Po ashtu analizat tona vit pas viti kanë vënë në dukje nevojën serioze për investime në sektorin e ujit nëse dëshirojmë që të mos vazhdojë edhe më tej përkeqësimi aktual në nivel të shërbimeve. Rrjedhimisht ne kemi qenë të kujdesshëm në qasjen tonë sa i përket sifidimit të programeve të investimeve dhe kemi preferuar rritje të investimeve në rritje infrastrukturore dhe mirëmbajtje kapitale në mënyrë që të përshpejtohet përmirësimi i nivelit të shërbimeve. Ne sygjerojmë menaxhmentin e KRU që të kenë një alokim më të madhe të angazhimeve menaxheriale në këto dy fusha, duke qenë të bindur se mungesa e progresit të tyre padyshim se do të reflektoj në përkeqësimin e nivelit të shërbimit.

Shpenzimet kapitale për ujë

Paraqesin totalin e shpenzimeve kapitale të realizuara për mirëmbajtje dhe rritje kapitale në shërbimet e ujit në raport me shpenzimet kapitale të aprovuara në planin e biznesit. (2012-2014), për vitin 2013.




Figura 16, Shpenzimet kapitale për furnizim me ujë në raport me ato të planifikuara

Kompanitë për vitin 2013 kanë paraparë shpenzime të konsiderueshme për mirëmbajtje dhe rritje kapitale dhe atë rreth 25.7 mil.€. Këto mjete janë paraparë të sigurohen si nga mjetet vetanake ashtu edhe nga donacionet. Në realitet shpenzimet aktuale ishin më të ulëta se niveli i pritshëm dhe atë prej 14.8 mil.€ apo 57% nga ajo që ishte planifikuar.

Vihet re se shumica e investimeve të realizuara e të deklaruara nga kompanitë kanë vazhduar të jenë kryesisht nga Grantet, (donacionet zhvillimore) përjashtuar KRU 'Hidromorava' dhe KRU 'Bifurkacioni' të cilat në vitin 2013 nuk kanë pranuar asnjë donacion. Vlera e investimeve nga grantet për vitin 2013 ka qenë rreth 12.8 mil.€ euro ndërsa pjesa tjetër prej të hyrave vetanake.

Në nivel të sektorit për vitin 2013 kompanitë nga të hyrat vetanake kane planifikuar të shpenzojnë rreth 7,4 mil.€ të cilat edhe janë mbuluar nga tarifat e aprovuara, por kompanitë për vitin 2013 kanë realizuar vetëm 2 mil.€ apo 27%, por nëse e krahasojmë me vitin paraprak investimet nga të hyrat vetanake në nivel të sektorit kanë qenë më të larta për 801,812€ ose 65%.

Tabela 1, Vlera e investimeve në shërbimin e ujit

Realizimi i investimeve në shërbimet e ujit nga të hyrat vetanake dhe grantet për vitin 2013				
Kompania	Inv. në prodhim	Inv. në distribuim	Inv. në aktivitete biznesore	Totali
KRU "Prishtina"	1,531,719	7,154,627	221,856	8,908,202
KRU "Hidroregjioni Jugor"	820,182	596,876	128,696	1,545,754
KRU "Hidrodrini"	182,739	660,353	51,856	894,948
KRU "Mitrovica"	-	1,967,316	79,703	2,047,019
KRU "Radoniqi"	609,618	461,825	257,820	1,329,263
KRU "Bifurkacioni"	3,200	32,609	17,472	53,281
KRU "Hidromorava"	8,862	6,638	15,541	31,041
Totali	3,156,320	10,880,244	772,945	14,809,508

KRU 'Prishtina', edhe këtë vit prin me realizimin e shpenzimeve kapitale (8,908,202€). Me këto shpenzime, është synuar të përmirësohet vazhdimësia e furnizimit më ujë (ndërtimi i rezervuarëve, ndërtimi i pompave etj), të përmirësohet shërbyeshmëria e infrastrukturës dhe ngritja e nivelit të standardeve të shërbimeve (ndërrimin e gypave të ujit, shpërndarjen e rrjetit të ujësjellësit, vendosjen e ujëmatësve).

KRU 'Hidroregjioni Jugor', 'Radoniqi' dhe 'Hidrodrini', kanë realizuar shpenzime kryesisht në rritje të infrastrukturës dhe jo-infrastrukturës në prodhim dhe distribuim dhe atë në ndërtimin e rrjetit të ri të ujësjellësit, ndërtimin e stacionit të pompave, ndërtimin e rezervuarve, instalim të ujëmatësve, etj.

KRU 'Mitrovica', vlerën e investimeve prej 2,047,019€ të pranuar nga grantet i ka realizuar kryesisht në mirëmbajtje të rrjetit të ujësjellësit, përderisa shpenzimet kapitale për vitin 2013 kanë qenë të orientuara në projektet që lidhen me zgjerimin e kapaciteteve prodhuese dhe vendosje të ujëmatësve të cilat do të ndikojnë shumë në vazhdimësinë e furnizimit me ujë e të cilat projekte pritet se do të përfundojnë në të ardhmën.

Kompania e cila ka realizuar më së paku investime në shërbimet e ujit ka qenë KRU 'Hidromorava', me 31,041€ ose 14% nga ajo e planifikuar.

Ne jemi të mendimit se ndikimin kryesor për mos përmbytjen e investimeve të planifikuara në lartësinë e aprovuar mund ti atribuohet mos realizimit të objektivave të faturimit dhe të arkëtimit si dhe rritjes së shpenzimeve operative. Duke rezultuar me mungesën e mjeteve aq të nevojshme për investime. Sidomos Rregullatori mbetet i shqetësuar për vonesat në projektet e mëdha që kanë bërë pjesë në investimet e lejuara nga mjetet vetanake të cilat kanë qenë pjesë e ngarkesës tarifore, meqenëse konsumatorët janë në pritje të përmirësimit të shërbimit.

3.2 Shërbimet për ujërat e zeza

3.2.1 Performanca teknike

Cilësia e ujërave të zeza të shkarkuara

Për shkak të mungese së trajtimit të ujërave të zeza, ende nuk mund të bëjmë një vlerësim të KRU në këtë drejtim, shpresojmë që së shpejti do të fillojmë me trajtimin e ujërave të zeza, meqëse shumë projekte tani më veç janë finalizuar dhe pritët implementimi i tyre.

Besueshmëria dhe shërbyeshmëria

Ky nën seksion, raporton informacion lidhur me besueshmërinë e shërbimeve të kanalizimeve nga dy aspekte, nga aspekti i mbulueshmërisë me shërbime si dhe besueshmëria e shërbimit të kanalizimit e cila është e ndikuar nga frekuenca e dështimit të shërbimit të kanalizimeve për 100 kilometra të rrjetit kryesore.

Frekuenca e bllokimit të kanalizimeve

Një bllokim i kanalizimit është një pengesë e pjesshme ose e përgjithshme e një gypi kryesor të sistemit të kanalizimit që pengon rrjedhjen e ujërave të zeza. Kjo përfshinë të gjitha bllokimet në rrjetin kryesor i cili është nën përgjegjesin e ofruesit të shërbimeve duke përjashtuar bllokimet në rrjetin e brendshëm të konsumatorëve.

Një bllokim i sistemit të kanalizimit mund të çojë në një derdhje të ujërave të zeza për shkak të mos pastrimit apo të kapacitetit të rregullt të zvogëluar të kanalizimit për të përcjellur vëllimin e ujërave të zeza, sidomos në kohë të shirave me sasi të madhe. Përveç mosmenaxhimit të aseteve të rrjetit të kanalizimit nga ana e KRU i cili ka ndikim parësor në performancën e kanalizimit. Janë vete qytetarët ata që në shume raste, kontribuojnë në bllokimin e sistemit duke hedhur mbeturina të ngurta në kanalizim.

Numri i bllokimeve të kanalizimit për 100 km gjatësi të rrjetit




Figura 17, numri i bllokimeve të kanalizimit

Në figurën 17, është paraqitur numri i incidenteve gjatë vitit të raportuar nga KRU në lidhje me bllokimet e kanalizimeve në raport me 100 km gjatësi të rrjetit të kanalizimit.

Norma mesatare gjatë vitit 2013 numri i bllokimeve në rrjetin e kanalizimit për 100 km gjatësi në nivel sektori është raportuar të jetë në nivel më të lartë krahasuar me vitin 2012 për 99.5%.

Nga shumica e KRU gjatë vitit 2013 në raport me vitin 2012, ka pas rritje të numrit të bllokimeve në përjashtim të KRU 'Radoniqi' rrjeti i se cilës ka pasur, performancë më të mirë.

Incidentet më të larta gjatë vitit 2013 i ka KRU 'Prishtina' me 2,933 defekte për 100 km gjatësi të rrjetit të kanalizimit, kjo vlerë ka ardh si rezultat i paraqitjes të një numri të madh të ankesave nga ana e konsumatorëve për bllokimet e evidentuara në teren.

Ndërsa kompania e cila ka numrin më të vogël të incidenteve të paraqitura është KRU 'Hidrodrini', me 328 bllokime për 100km gjatësi e cila nëse krahasohet me vitin paraprak ka shënuar përmirësim.

Performanca e këtij treguesi varet direkt nga vjetërsia e rrjetit egzistues të kanalizimit. Ky tregues bënë matjen e performancës së gjendjes së rrjetit egzistues të kanalizimit me qëllim të orientimit të investimeve në drejtim të ripërtëritjeve infrastrukturore.

Norma e lartë e Bllokimeve të kanalizimit paraqet nevojën imediate për investime në këtë fushë, si dhe mirëmbajtje (pastrim) më të mirë të sistemit të kanalizimit. KRU duhet të kenë të dizajnuar dhe të zbatuar programet për pastrimin e sistemit të kanalizimit e cila është edhe një kërkesë ligjore.

Mbulueshmëria me shërbime të kanalizimit

Mbulueshmëria me shërbime të kanalizimit është e definuar si përqindja e popullsisë brenda zonës së shërbimit që ju ofrohen shërbimet e kanalizimit.




Figura 18, Mbulueshmëria me shërbimet e kanalizimit

Në vitin 2013, shkalla e mbulueshmërisë me shërbimet e kanalizimit arrin nivelin 60%, e cila në raport me vitin 2012 është për 3% më e lartë.

Të gjitha kompanitë kanë shënuar progres në këtë tregues gjatë vitit 2013, në raport me vitin paraprak në përjashtim të, KRU 'Hidrodrini' dhe KRU 'Hidroregjionit Jugor' të cilat nuk kanë pasur ndonjë përmirësim në këtë shërbim.

KRU 'Prishtina, ka mbulueshmërinë më të lartë në zonën e saj të shërbimit në vitin 2013 ku ka arritur nivelin 78%, e cila nëse krahasohet me vitin 2012 është për 6% vlerë më e lartë.

Përmirësimin më të lartë nga të gjitha kompanitë e tjera, e ka arritur KRU 'Bifurkacioni' gjatë vitit 2013 në raport me vitin 2012, duke e rritur mbulueshmërinë e popullatës me këtë shërbim për 10%, apo mbi 3 mijë konsumatorë më shumë si rezultat i drejtpërdrejtë i zgjerimit të zonave me shërbime të kanalizimit.

Edhe gjatë vitit 2013 KRU 'Hidrodrini', vazhdon të karakterizohet me performancën më të dobët me shërbime të kanalizimit me vetëm 41% mbulueshmëri të zonës së tij.

Objektivat si mesatare të sektorit të planifikuara për vitin 2013, gjatë procesit aktual tarifar është përmbushur, për faktin se numri i konsumatorëve të rinjë të kyçur në shërbimet e kanalizimit nga KRU, është në përputhje me planifikimet. Po ashtu edhe KRU 'Hidroregjioni Jugor', 'Hidrodrini' dhe KRU 'Bifurkacioni', individualisht kanë arritur ti kalojnë objektivat e planifikuara në planet e tyre të bizneseve për vitin 2013.

Niveli i mbulueshmërisë me kanalizim dhe në veqanti ai në trajtimin e ujërave të zeza në vendin tonë ende mbetet shumë i ultë, prandaj nevojat për investime në këtë drejtim janë shumë të mëdha. Gjatë rishikimit të planeve të biznesit të KRU, ne nuk kemi sfiduar projeksionet në lidhje me planet për rritjen e numrit të konsumatorëve. Arritjet e parashikimeve të rritjes së numrit të konsumatorëve ne i kemi parë si vendimtare për suksesin e biznes planeve të KRU. Pa të ardhura shtesë të gjeneruara nga kjo rritje nuk ka gjasa që KRU të jenë në gjendje për të përmbushur objektivat e tyre të investimeve.

3.2.2 Performanca komerciale

Ankesat

Në këtë seksion kemi paraqitur, numrin e përgjithshëm të ankesave të pranura nga ana e KRU përmes të cilave konsumatorët kanë shprehur pakënaqësi e tyre në nivelin e ofrimit të shërbimeve të ujërave të zeza. Ankesat përfshijnë të dyja aspektet, teknike dhe ato komerciale. Përderisa ankesat teknike, për shërbimin e ujërave të zeza në përgjithësi kanë të bëjnë me bllokimet e kanalizimeve, ankesat e natyrës komerciale me tepër janë për shkakun e kontestimit të saktësisë dhe mënyrës së faturimit.




Figura 19, Ankesat për shërbimet e ujërave të zeza

Mesatarja e numrit të ankesave të paraqitura nga ana e konsumatorëve për shërbimet e ujërave të zeza gjatë vitit 2013 ka shënuar rënje krahasuar me vitin paraprak dhe atë për 16%. Numri total i ankesave për shërbimet e ujërave të zeza arrin vlerën 5,213 prej të cilave 5,181 apo 99% kanë të bëjnë me aspektet teknike dhe vetëm 32 sish apo 1%, përfshijnë aspektet komerciale.

Nga të gjitha KRU, është raportuar rritje e numrit të ankesave, duke përjashtuar nga ky rast KRU 'Hidroregjionin Jugor' dhe KRU 'Mitrovica' të cilat kanë ndikuar që kjo e dhënë të bie në mesatare të sektorit gjatë vitit 2013 në raport me vitin paraprak.

KRU 'Mitrovica', ende nuk ka arritur të vendos një sistem të mirëfilltë të menaxhimit në përgjithësi të ankesave të konsumatorëve të saj. Ky është shkak i mos raportimit të ankesave edhe pse ka indikacione që konsumatorët kanë adresuar ankesat e tyre në lidhje me pakënaqësinë me nivelin e shërbimit të ujërave të zeza nga kjo kompani.

3.2.3 Performanca financiare

Vlerësimi i performancës financiare, përfshinë aspektet financiar të shërbimit të ujërave të zeza në treguesit vijues: shitjet për shërbimin e ujërave të zeza, kostot njësi dhe investimet kapitale në shërbimin e ujërave të zeza.

Vlera e shitjeve të shërbimeve të ujërave të zeza (EUR)

Figura si me poshtë paraqet performancën e shitjeve të shërbimeve të ujërave të zeza në krahasim me vlerësimet e planifikuara ashtu siç ishin të përcaktuara në aplikacionet tarifore të KRU për procesin e rishikimit tarifor 2012-2014.




Figura 20, Shitjet e shërbimeve të ujërave të zeza në raport me planifikimet

Për shkak të nën-performancës së konsiderueshme të shitjeve aktuale të ujit krahasuar me shitjet e planifikuara, vlera e shitjeve aktuale në shërbimet e ujërave të zeza, gjithashtu është nën vlerat e planifikuara pasi që është drejtpërdrejtë e lidhur me volumet e shitjeve të ujit.

Asnjë nga KRU, nuk kanë mundur të arrijnë objektivat e shitjeve të ujërave të zeza, gjatë vitit 2013.

Caku i arritur për 2013 në nivel të sektorit është 74%, dhe është me i vogël për 7% nga ajo që ishte në vitin 2012.

Edhe këtë vit KRU 'Radoniqi' ka arritur përqindjen më të lartë, krahasuar me kompanitë e tjera me 96%, mirëpo, nëse krahasohet me vitin 2012, kjo kompani ka realizuar shitje të shërbimeve të ujërave të zeza më pak për 7%.

KRU "Hidrodrini" është kompania e cila ka pasur ndryshimin më të madh krahasuar me vitin 2012, me një rënie prej 29% rezultat i të cilës ka qenë rënia e te ardhurave të realizuara nga shërbimet e ujërave të zeza prej 20% dhe ngritjes së faturimit të planifikuar për 17%.




Figura 21, vlera relative e shitjeve të shërbimeve të kanalizimit gjatë 2013 në raport me 2012.

Shitjet totale për njësi e shërbimeve të ujërave të zeza e realizuar në raport me planifikimet

Kostoja totale për njësi e shërbimeve të ujërave të zeza është një tregues financiar i cili po ashtu njëllojë sikurse të furnizimi me ujë radhitet në grupin e treguesve kryesor në bazë të cilëve i'u matet performanca e ujërave të zeza.

Treguesi i paraqitur grafikisht si më poshtë paraqet raportin në mes koston për njësi të shërbimeve të ujërave të zeza të realizuara (shpenzimet operative duke përfshirë mirëmbajtjen kapitale/me ekuivalentet e konsumatorëve shtëpiak⁸) dhe koston për njësi të shërbimeve të ujërave të zeza të planifikuara (shpenzimet operative duke përfshirë mirëmbajtjen kapitale/ ekuivalentet e konsumatorëve shtëpiak).




Figura 22, Kostoja për njësi e shërbimeve të ujërave të zeza në raport me koston e planifikuara për njësi

Kostot e planifikuara për njësi që rrjedhin nga rishikimi tarifar 2012-2014 (të rregulluara sipas niveleve të çmimeve në 2013), tek të gjitha KRU ishin më të ulëta se sa ato të planifikuara, megjithatë, kjo nuk tregon efikasitet më të madhe se sa ishte planifikuar për arsye se koston e planifikuara për njësi kanë

⁸ Konsumatorët shtëpiak të shërbyer definojnë si numri aktual i konsumatorëve shtëpiak plus numri i konsumatorëve jo shtëpiak të konvertuar në ekuivalent të konsumatorëve shtëpiak bazuar në ndarjen proporcionale të ujit të konsumuar.

përfshirë shpenzime të konsiderueshme për ripërtëritje infrastrukturore dhe zhvlerësim sipas kostos aktuale për asetet e reja, e që asnjëra nuk ka arritur ti realizoj.

Edhe pse KRU 'Radoniqi', në krahasim me kompanitë e tjera ka arritur përqindjen më të lartë të realizimit nga caku i planifikuar, prapë nuk ka treguar performancë të mirë, për arsye se ka tejkaluar shpenzimet operative për 209% duke mos realizuar as 8% të shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale. Shkak i ndryshimit të lartë në vitin 2013 krahasuar me vitin 2012 të KRU "Hidrodrini", janë planifikimet e ulëta në vitin 2012 të mirëmbajtja kapitale, e cila pastaj ka qenë edhe ma e lehtë të realizohet, ndërsa në vitin 2013, mirëmbajtja kapitale ishte planifikuar sa katërfishi i planifikimeve në vitin 2012, duke ndikuar në realizimin koston për njësi në vetëm 33%.

Kostoja totale për njësi për shërbimin e ujërave të zeza

Nënkupton shpenzimet totale operative për ujëra të zeza, përfshirë mirëmbajtjen kapitale të ujërave të zeza në raport me ekuivalentët e konsumatorëve shtëpiak për vit⁹.




Figura 23, Kostoja për njësi të shërbimeve të ujërave të zeza (operativ+mirëmbajtje kapitale)

Kostoja për njësi e shërbimeve të ujërave të zeza në nivel të sektorit në vitin 2013 krahasuar me vitin 2012 ka qenë me e ultë për 0.08¹⁰ €/m³ apo për 2%.

Tri nga shtatë kompanitë në vitin 2013, kanë treguar trende negative me një ngritje prej 1.15€ (Radoniqi'), 0.64 (Bifurkacioni) dhe 0.21 (Hidroregjioni Jugor). Rritja e kostove për njësi të shërbimeve të ujërave të zeza mund t'i atribuohet rritjeve të dukshme të shpenzimeve operative për shërbimin e ujërave të zeza dhe shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale për këtë shërbim.

Koston më të ulët në këtë tregues e ka KRU 'Prishtina', 2.83 €/kons. e cila përkundër ngritjes së shpenzimeve totale për shërbimet e ujërave të zeza duke përfshirë edhe mirëmbajtjen kapitale ka pasur përmirësim për 0.10 €/kons. krahasuar me vitin 2012 e cila ishte 2.93 €/kons.

Përmirësimin më të lartë në vitin 2013 krahasuar me vitin 2012 ka pasur KRU 'Mitrovica', me një rënie prej 1.49, rezultat i të cilës ka qenë zvogëlimi i shpenzimeve operative në shërbimin e ujërave të zeza, përkundër rritjes se numrit të konsumatorëve.

Megjenëse nuk janë futur ende në përdorim impiantet për trajtimin e ujërave të zeza koston për njësi të shërbimeve të ujërave të zeza mbetin shumë me të ulëta krahasuar me koston e furnizimit me ujë.

⁹ Konsumatorët shtëpiak të shërbyer definohe si numri aktual i konsumatorëve shtëpiak plus numri konsumatorëve jo shtëpiak të konvertuar në ekuivalent të konsumatorëve shtëpiak bazuar në ndarjen proporcionale të ujit të konsumuar.

¹⁰ Kostoja për njësi e vitit 2012 është e rregulluar me normën e inflacionit 1.017626

Shpenzimet kapitale për ujëra të zeza

Paraqesin totalin e shpenzimeve kapitale të realizuara për mirëmbajtje dhe rritje kapitale në shërbimet e ujërave të zeza, në raport me shpenzimet kapitale të aprovuara në planin e biznesit për vitin 2013.




Figura 24, Shpenzimet kapitale për shërbime të ujërave të zeza në raport me ato të planifikuara në 2013

Edhe të shërbimi me ujëra të zeza njëjtë sikur të shërbimi me ujë, kompanitë për vitin 2013, kanë paraparë provizionime të konsiderueshme rreth 5,5mil.€ për rritje kapitale dhe mirëmbajtje kapitale, e të cilat janë parapar të sigurohen si nga mjetet vetanake ashtu edhe nga donacionet, por në realitet shpenzimet aktuale ishin shumë më të ulëta se niveli i pritur dhe atë prej 108,631€ ose 1.97% nga ajo që ishte planifikuar.

Është evidente se shumica e investimeve të realizuara janë nga donacionet prej 84,755€ apo 78%, ndërsa pjesa tjetër është nga të hyrat vetanake gjithsejtë 23,876€ .

Nga mjetet vetanake të planifikuara të shpenzohen në shërbimin e ujërave të zeza në shumë prej 1,4 mil.€ dhe të cilat janë mbuluar nga tarifat e aprovuara, janë realizuar vetëm 23,876€ apo 2%, ndërsa nëse e krahasojmë me vitin paraprak investimet nga të hyrat vetanake ne nivel të sektorit kane qenë më të ulëta për 15,265 € apo për 39%.

Tabela 2, Vlera e investimeve në shërbimin e ujërave të zeza

Realizimi i investimeve në shërbimet e ujërave të zeza nga të hyrat vetanake dhe grantet për vitin 2012					
Kompania	Inv.në grumbullim	Inv.në trajtim	inv.në shkarkim	inv.akt. biznesore	Totali
KRU "Prishtina"	79,005	-	-	1,814	80,819
KRU "Hidroregjioni Jugor"	-	-	-	328	328
KRU "Hidrodrini"	-	-	-	2,729	2,729
KRU "Mitrovica"	-	-	-	5,087	5,087
KRU "Radoniqi"	-	-	-	13,569	13,569
KRU "Bifurkacioni"	3,200	-	-	1,728	4,928
KRU "Hidromorava"	-	-	-	1,170	1,170
Totali	82,205	-	-	26,426	108,631

Njëjtë sikur të investimet në shërbimet e ujit edhe të ujërat e zeza prin KRU 'Prishtina' me realizimin e investimeve prej 74%, të shumës totale të investimeve (108,631.07), nga të cilat 73% kanë qenë kryesisht në zgjerimin e rrjetit të kanalizimit dhe ndërtimin e kolektorit për ujëra të zeza, kompanitë e tjera nuk kanë arritur që as 1% të vlerës totale të investimeve të investojnë në shërbimin e ujërave të zeza, përjashtuar KRU 'Bifurkacioni'.

KRU 'Radoniqi', ka realizuar investimet e planifikuara në nivelin më të lartë prej 8.91%, kompanitë e tjera kanë pasur investime shumë të vogla në shërbimet e ujërave të zeza për vitin 2013.

KRU 'Hidroregjioni Jugor', është një ndër kompanitë që ka planifikuar shpenzime domethënëse kapitale në shërbimin e ujërave të zeza si në mirëmbajtje të rrjetit ashtu edhe në ndërtimin e kolektorëve për largimin e ujërave të zeza e të cilat nuk ka arritur as 0.05% , të tyre ti realizoj dhe atë vetëm në aktivitetet biznesore.

3.3 Performanca financiare e KRU

Arkëtimi i të ardhurave

Në vijim është paraqitur performanca e kompanive tek treguesi shkalla e arkëtimit për vitin 2013 krahasuar me 2012, i paraqitur si raporti në mes arkëtimit të keshit ndaj faturimit për shërbimet e ofruara të ujit dhe ujërave të zeza (faturimi për tarifën fikse, volumetrike të ujit dhe të ujërave të zeza).




Figura 25, Efienca në arkëtimin e të ardhurave

Në vitin 2013, shkalla e arkëtimit për faturat e shërbimit të ujit dhe të kanalizimit si mesatare e sektorit është 71%, që do të thotë se krahasuar me vitin paraprak kemi pasur rritje për 1%.

Siç ilustron edhe nga figura me lartë në vitin 2013 progresin me të mirë në shkallën e arkëtimit e ka arritur KRU 'Hidrodrini' me një ngritje prej 8% krahasuar me vitin paraprak, rezultat i të cilës përveç zvogëlimit të faturimit kanë qenë edhe shkyçjet individuale.

Gjatë vitit në shqyrtim, ka pasur një përmirësim në shkallën e arkëtimit në KRU Prishtina, Hidroregjioni Jugor, Hidrodrini dhe Bifurkacioni përderisa një paqëndrueshmëri në shkallën e arkëtimit kanë shënuar KRU (Radoniqi, Hidromorava si dhe Mitrovica).

Efienca e arkëtimit nga kategoria e konsumatorëve të amvisërisë vazhdon të jetë e dobët tek të gjitha kompanitë. KRU 'Radoniqi' mban rekord gjatë viteve të fundit në këtë kategori me 73% e përcjellur pastaj nga KRU 'Prishtina' me 67%.

KRU 'Prishtina', ka shënuar progres të vazhdueshëm vit pas viti duke arritur në nivelin prej 76%, kryesisht si rezultat i angazhimeve të kësaj kompanie në shqyçjet konsumatorëve borxhlinjë.

Performancën më të ultë në shkallën e arkëtimit njëjtë sikur vitin e kaluar, ka realizuar KRU 'Mitrovica' me vetëm 48%.

Caku i Planifikuar për 2013 në nivel të sektorit ka qenë 75%, dhe aktualisht në nivel të sektorit ka mundur të arkëtohen vetëm 71% të shumës së faturuar, e qe do të thotë se shkalla aktuale e arkëtimit të të ardhurave në nivel të sektorit ka paraqitur devijim prej 4%, kundrejt planit.

Në rritjen e shkallës së arkëtimit prej 71% në nivel të sektorit kryesisht ka ndikuar arkëtimi i të ardhurave nga institucionet duke tejkaluar cakun e planifikuar për 6%.

Siç vërehet edhe nga tabela 3, të gjitha kompanitë kanë dështuar në përmbushjen e objektivit të caktuar individual, me përjashtim të KRU 'Prishtina' e cila ka arritur nivelin e arkëtimit të planifikuar prej 76%.

Tabela 3, Performanca aktuale dhe e planifikuar e arkëtimit të të ardhurave për vitin 2013

Kategoria e Konsumatorëve	KRU Prishtina		KRU Hidroregjioni Jugor		KRU-Hidrodrini		KRU Mitrovica		KRU Radoniqi		KRU Bifurkacioni		KRU Hidromorava	
	Real.	Plan.	Real.	Plan.	Real.	Plan.	Real.	Plan.	Real.	Plan.	Real.	Plan.	Real.	Plan.
Amvisëri	67%	65%	65%	66%	54%	65%	38%	51%	73%	76%	50%	69%	61%	76%
Komercial-Industrial	91%	94%	55%	83%	69%	85%	72%	91%	64%	78%	124%	65%	81%	91%
Institucione	91%	100%	130%	94%	97%	92%	88%	99%	116%	96%	141%	96%	118%	96%
Totali	76%	76%	72%	75%	64%	73%	48%	64%	75%	78%	60%	80%	70%	80%

Shkallla e raportuar e arkëtimit për të gjithë ofruesit e shërbimeve është ende e ulët dhe ka ndikim të drejtëpërdrejtë në gjëndjen financiare të ofruesve të shërbimeve. Ofruesit e shërbimeve duhet të ndërmarrin masa edhe veprime inovative për inkurajimin e konsumatorëve për të bërë pagesat e shërbimit.

Konsumatorët po ashtu duhet të jenë më të ndërgjegjshëm se faturat duhet paguar. ZRRUK ka punuar me kompanitë për të siguruar që politikat e drejta do të zbatohen nëse vjen deri te shqyçja nga shërbimet e ujësjellësit. Sa i përket rasteve të konsumatorëve që kanë vërtetë vështirësi për të paguar, ata duhet të ndihmohen por ne duhet të zhdukim dukurinë “nuk dua të paguaj”, mentalitet i cili është shumë i përhapur në mesin e atyre që mund të përballojnë që të paguajnë faturat e tyre.

Kthimi në kapital

Është i definuar si kthimi në bazën rregullatore të aseteve i paraqitur si të ardhura vjetore dhe rritje e kapitalit nga investimet e shprehura si përqindje e investimit origjinal.

Kthimi në kapital është i nevojshëm për të siguruar besimin e investitorëve në sektorë, nëse kompanitë duan që të tërheqin financime për përmirësimin e aseteve në mënyrë që të përmbushin përmirësimin e nevojshëm të nivelit të shërbimit.

Baza rregullatore e aseteve (BRA) mbi të cilën është përcaktuar kthimi në kapital, është përcaktuar në vitin 2008 që nga procesi tarifar (2009-2011), ka filluar me 1 Janar 2009 me bazën rregullatore të

aseteve (BRA) për secilën prej kompanive të ujit, duke përdorur vlerën e përcaktuar të asetëve prej 200€ për konsumatorët e shërbimit të furnizimit me ujë dhe 100€ për konsumatorët e ujërave të zeza.

Norma reale e kthimit në kapital është e bazuar në praktikat e mira të vendeve të Europës Perëndimore, dhe tek ne për procesin tarifor (2012-2014), kemi llogaritur që kjo të jetë 5.30% si shumë e kalkuluar para normës së inflacionit.




Figura 26, Kthimi në bazën rregullatore të asetëve (BRA)

Kthimi në kapital në nivel të sektori ka pasur përqendrim në vitin 2013 krahasuar me vitin 2012 dhe atë për 1.14%.

Vetëm dy KRU (Hidromorava dhe Radoniqi) kanë pasur kthime pozitive, madje duke tejkaluar nivelin e planifikuar prej 5.30%, e të cilat edhe kanë arritur ti mbajnë shpenzimet e tyre, përfshirë zhvlerësimin sipas kostos aktuale dhe mirëmbajtjen infrastrukturore në BRRA, brenda kufijve të të ardhurave të tyre dhe duke u dhënë mundësin për të bërë investime të reja.

Për dallim nga viti i kaluar ku KRU 'Mitrovica' kishte përmirësimin me të lart në krahasim me kompanitë e tjera, në vitin 2013 ka shënuar rënjen më të lartë të normës së kthimit për 6.54% duke mos arritur ti mbulojë as shpenzimet operative si rezultat i zvogëlimit të të hyrave dhe rritjes së provizionimit të borxheve të këqija për 25%.

3.4 Performanca e përgjithshme e KRU

Arsyeshmëria

Monitorimi i Performances dhe vlerësimi krahasues (Benchmarking) është thelbësor për zhvillimin dhe zbatimin e politikave që kanë qëllim përmirësimin e shërbimit nga ofruesit e shërbimeve të ujit. Nëse një vendimmarrës nuk e dinë se ku kanë qenë dhe ku janë ata, kjo do të duket të jetë e pamundur për të vendosur objektiva të arsyeshme për ecurinë e ardhshme. Informacionet për KRU për aspektet operative, financiare dhe të shërbimeve ndaj konsumatorëve janë të rëndësishme për menaxhim dhe mbikëqyrje të mirë. Regjimi i ri i zhvilluar së fundi i kornizës së raportimit dhe vlerësimit të performancës nga ZRRUK, kërkon nga KRU raportimin e të dhënave për nevojat e kërkesave rregullatore të cilat në fokus kanë përfitime për konsumatorët. Metodologjia e re e vlerësimit të performancës, bënë matjen:

- (i) Performancës relative ndaj 'premtimeve' të biznes planit, (krahasimi i performancës kundrejt propozimeve / caceve tarifore),
- (ii) Performancës absolute relative ndaj pritjeve ideale të performancës,
- (iii) Performancës relative krahasuese në mes KRU dhe kundrejt performancave të viteve të kaluara, si dhe
- (iv) Performancës së sektorit, (informacione për Politik-bërsitë dhe Donatoret, etj.)

Korniza e raportimit të performancës (të dhënat, treguesit dhe definicionet), janë harmonizuar me mjetet e tjera rregullatore (Biznes planet e Kompanive, Llogarit rregullatore, Procesin Tarifor, Standardet e shërbimit) të përdorura të cilat kanë qenë të nevojshme për të matur performancën jo vetëm kundrejt viteve të kaluara, por që është më e rëndësishme, kundrejt caceve të dakorduara të performancës në aplikacionet tarifore.

Vlerësimi i performancës

Vlerësimi i performancës së KRU, është bërë në bazë të 11 Treguesve Kyq të Performancës, të cilët i përmbushin kriteret e të qenit të rëndësishëm, reflektojnë besueshmërinë e shërbimit, si dhe promovojnë efikasitetin financiar në të dy shërbimet: Furnizimi me ujë dhe Shërbime të ujërave të zeza. Vlerësimi i performancës është në përputhje me praktikën e mira ndërkombëtare që janë në zbatim nga rregullatorët e këtij sektori, ku në fokus janë kërkesat specifike rregullatore, në nivele të veçanta të shërbimeve dhe të implikimeve të kostos për konsumatorin. Në përdorim pra, është vendosur koncepti i vlerësimit të performancës ndaj kompanisë e cila funksionon mirë dhe ofron shërbime efikase në; Furnizimin me ujë dhe Shërbime të ujërave të zeza, mbi bazën e cilësisë së ujit, niveleve të shërbimit, mbulueshmërisë si dhe efikasitetit komercial dhe financiar.

Kriteret për matjen e performancës së furnizimit me ujë dhe shërbimeve të ujërave të zeza janë të atilla që poentimi prej 100% reflekton ofrimin e një niveli të tillë të shërbimit të krahasueshëm me performancën e ofruesit modern mirë funksionues të furnizimit me ujë apo shërbime të ujërave të zeza.

Duke u bazuar në rezultatet e performancës së demonstruar në vitin 2013, ZRRUK ka bërë rangimin e KRU-ve. Në tri aspekte: Furnizim me ujë, shërbime të ujërave të zeza dhe performancën e përgjithshme të KRU. Referencë kryesore e përdorur për renditjen e performancës të kompanive është performanca e tyre në raport me përmbushjen e objektivave të performancës së synuar ideale.

Shërbimet e furnizimit me ujë

Vlerësimi i performancës si dhe rangimi i KRU, në shërbimin e furnizimit me ujë, është bërë përmes (5) pesë, Treguesve Kyq të Performancës.

- (i) **Mbulueshmëria me shërbime**, duke synuar mbulueshmëri complete (100%) në zonën respektive të shërbimit
- (ii) **Cilësia e ujit të furnizuar**, e cila është 100% në pajtueshmëri me standardet e specifikuar vendore;
- (iii) **Presioni i ujit**, brenda referencave ligjore vendore me nivelet e specifikuar minimale (25 m.sh.u) dhe maksimale (70 m.sh.u);
- (iv) **Disponueshmëria e furnizimit me ujë**, uji për të gjithë konsumatorët në baza të vazhdueshme për 24 orë në ditë dhe shtatë ditë në javë;
- (v) **Efiçenca e kostos**, kosto efiçente për njësi e ujit të shitur dhe në përputhje me pritjet sipas planit të biznesit.




Tabela 27, paraqet rezultatet në vlerësimin e performancës së furnizimit me ujë si dhe rangimin e KRU

Niveli i përgjithshëm mesatar i performancës së furnizimit me ujë në 2013, është në nivelin 36.7% nga maksimumi prej 45% e ndarë për këtë shërbim, kjo është për 1.1% më e ultë se në vitin 2012, ku ajo ishte në nivelin 37.8%.

Efiçenca e kostove me 2.7% si dhe disponueshmëria me furnizim me ujë 0.3%, kanë qenë dy fusha ku performanca ka qenë më e dobët se në vitin paraprak 2012. Përfshirë KRU 'Radoniqi' dhe KRU 'Hidromorava', në të gjitha kompanitë e tjera rajonale, efiçenca e kostove ishte me e ultë në 2013/2012.

Në vitin 2013, asnjë nga KRU nuk ka qenë në mundësi të ofrojë furnizim të plotë për konsumatorët e tyre. Për më tepër në KRU 'Prishtina', situata është përkeqësuar edhe më tej për shkak të zvoglimit të resurseve ujore, si pasojë e thatësisë e cila ka mbretëruar në pjesën e dytë të vitit 2013, për të vazhduar edhe në pjesën e parë të vitit 2014.

Bazuar në kriteret e mësipërme të rangimit KRU 'Radoniqi', ofron shërbime më të mirë dhe kosto efiçente nga të gjitha KRU në shërbimin e furnizimit me ujë.

Përveç KRU 'Radoniqi' dhe KRU 'Hidromorava' të cili ka bërë përmirësime në vitin 2013, të gjitha kompanitë e tjera, kanë pasur trende të përkeqësimit në performancën e furnizimit me ujë në 2013/2012.

KRU 'Prishtina' me 3.9 % dhe KRU 'Hidrodrini' me 3.1%, janë dy kompanitë rajonale të cilat kanë pasur, shkallën më të lartë të dështimit të performancës në furnizimi me ujë në vitin 2013/2012.

Sa i përket rangimit të KRU, në performancën e furnizimit me ujë në 2013, kemi një ripozicionim të tyre. Tani KRU 'Radoniqi', është ranguar e 1-ra, në vend të KRU 'Hidrodrini', po ashtu edhe KRU 'Hidromorava', u zhvendosën në vendin e 3-të, nga pozita e 5-të, në vende të KRU 'Hidroregjioni Jugor'.

KRU 'Prishtina', dhe KRU 'Hidroregjioni Jugor', janë ranguar në pozita më të ulta. KRU 'Prishtina', ka lenë mbrapa vetem KRU 'Bifurkacioni' dhe KRU 'Mitrovica'. Keto në fakt, janë tri KRU, të cilat kanë probleme më të mëdha me disponueshmërinë e furnizimit me ujë për konsumatorët e tyre.

Shërbimet për ujërat e zeza

Vlerësimi i performancës së KRU, në shërbimin e ujërave të zeza, është parapar të bëhet përmes (4) katër, Treguesve Kryesor të performancës,

- (i) **Mbulueshmërisë me shërbime për ujëra të zeza**, për qëllime të raportimit të performancës një vlerë prej 95% e konsiderohet si një pritje ideale;
- (ii) **Cilësi e ujërave të zeza të shkarkuara**, në pajtueshmëri me vlerë prej 100% me standardet e specifikuar mjedisore;
- (iii) **Besueshmëri e shërbimeve për ujëra të zeza**, me zero shtëpi të prekura nga vërshimet e kanalizimeve;
- (iv) **Efiçenca e koston**, kosto efiçente për njësi të shërbimeve për ujëra të zeza për amvisëri; Aktualisht ne kemi pas mundësi të bëjme vlerësimin e arritjes së objektivave vetëm në dy tregues: Mbulueshmëria me shërbime të kanalizimit si dhe efiçenca e koston. Shpresojmë se në të ardhmen pas aplikimit të trajtimit të ujërave të zeza nga KRU, do të kemi mundësi të bëjmë vlerësime për treguesit e cilësisë së shkarkimit dhe besueshmërisë së shërbimit të trajtimit të ujërave të zeza. Pra, dy tregues të rëndësishëm dhe të vlefshëm në mbrojtje e mjedisit jetësor.




Figura 28, paraqet rezultatet në vlerësimin e performancës së shërbimeve të ujërave të zeza si dhe rangimin e KRU

Në vitin 2013, kemi ulje në performancën e përgjithshme të shërbimit të ujërave të zeza, përkeqësimi është për 1.0%, në raport me vitin paraprak 2012. Performanca e shërbimit të ujërave të zeza, këtë vit është përkeqësuar tek të gjitha KRU, përjashtuar KRU 'Bifurkacionin' e cila ka shënuar pak përmirësim.

Mbulueshmëria me shërbime të kanalizimit është një fushë e cila në vazhdimësi në nivel të përgjithshëm, ka shënuar përmirësime. Ndonëse, përmirësimet janë graduale ato janë domethënëse për mirëqënien e qytetarëve.

Përderisa KRU 'Bifurkacioni', mbanë vendin e 1-rë, me shërbime të ujërave të zeza, KRU 'Hidrodrini', është ranguar si kompania me performancën më të dobët në shërbimin e ujërave të zeza pa shënuar ndonjë përmirësim gjatë këtyre dy viteve.

Që nga viti 2010, kur ne filluam të bëjmë vlerësimin e performancës sipas metodologjisë së re, KRU mbeten njëjtë të ranguar, pa ndonjë ndryshim të befasishtëm në performancën e sektorit të shërbimeve të ujërave të zeza. Përjashtuar KRU 'Hidroregjioni jugor', e cila ka shënuar pak më tepër avancim në mbulueshmërinë me kanalizim gjatë kësaj periudhe dhe tani këtë vit rangohet e 3-ta, në performancën e shërbimit të ujërave të zeza.

Performanca e përgjithshme e KRU

Performanca e përgjithshme nuk bazohet në performancën krahasuese të njëri-tjetrit, por bëhet një krahasim në lidhje me nivelin 'ideal' të performancës së pritshme të kompanisë që funksionon mirë dhe ofron furnizim eficientë me ujë dhe shërbime për ujëra të zeza dhe paraqet kombinimin e rezultateve nga tri kategoritë e biznesit të kompanisë, dmth:

- (i) Performanca e furnizimit me ujë;
- (ii) Performanca e shërbimeve për ujëra të zeza si dhe
- (iii) Performanca e përgjithshme e biznesit për ujë dhe ujëra të zeza (efiçenca financiare).

Rezultatet e vlerësimit si dhe rangimi i KRU në performancën e përgjithshme, janë paraqitur në formë tabelare si dhe janë ilustruar në formë grafike.

Tabela 4, Rezultatet për performancën e përgjithshme të KRU në vitin 2012

KRU	Furnizimi me Ujë	Ujëra të Zeza	Profitabiliteti	Arkëtimi	Totali i pikëve
Ideale	45%	35%	10%	10%	100%
PE	44.0%	10.7%	8.7%	0.0%	63.5%
PR	37.3%	16.0%	6.2%	3.8%	63.3%
GJA	40.5%	12.2%	5.5%	4.4%	62.7%
PZ	40.3%	13.3%	3.2%	2.9%	59.7%
GJI	36.6%	10.9%	7.2%	3.5%	58.2%
FE	34.8%	14.8%	8.3%	0.0%	57.9%
MIT	31.1%	11.3%	3.3%	0.0%	45.7%
Totali i pikëve	37.8%	12.8%	6.1%	2.1%	58.7%

Tabela 5, Rezultatet për performancën e përgjithshme të KRU në vitin 2013

KRU	Furnizimi me Ujë	Ujëra të Zeza	Profitabiliteti	Arkëtimi	Totali i pikëve	Ndryshimi 2012/2013
Ideale	45%	35%	10%	10%	100%	
GJA	43.0%	11.2%	10.0%	3.8%	68.0%	5.3%
GJI	39.6%	10.5%	10.0%	2.5%	62.6%	4.4%
PR	33.4%	14.9%	5.5%	4.0%	57.8%	-5.5%
PZ	37.9%	11.5%	2.6%	3.1%	55.1%	-4.7%
FE	32.1%	15.4%	3.9%	0.0%	51.5%	-6.2%
PE	40.9%	9.2%	0.0%	1.1%	51.3%	-12.2%
MIT	30.1%	9.5%	0.0%	0.0%	39.6%	-6.1%
Totali i pikëve	36.7%	11.8%	4.6%	2.1%	55.1%	
Ndryshimi 2012/2013	-1.1%	-1.0%	-1.5%	0.0%	-3.6%	

Tabelat 4 dhe 5, Rezultatet e vlerësimit të performancës së përgjithshme të KRU, vitet (2012&2013).

Në vitin shqyrtues 2013, KRU kanë shënuar, performancë përgjithësisht më të ultë për 3.6 %, në raport me vitin 2012. Niveli i përgjithshëm ka rënë nga 58.7% për vitin 2012 në 55.1%. Performancë me e ultë, është shënuar në të dyja shërbimet: Furnizim me ujë me 1.1% dhe shërbim të ujërave të zeza me 1.0%. Performanca e përgjithshme financiare po ashtu nuk ka shënuar trend pozitiv, për më tepër, kompanitë janë më pak profitabile për 1.5%, në vitin 2013 në raport me vitin paraprak 2013. Në efikasitetin e arkëtimit mesatarja e sektorit nuk ka shënuar ndonjë përmirësim.

Shërbimi i ujërave të zeza është një fushë me potencial me të lartë të përmirësimit i cili aktualisht është në nivel shumë të ultë(11.8%) nga ajo e synuar prej 35%, të performancës së kompanisë ideale. Po ashtu ky shërbim është shumë me pak i zhvilluar se sa shërbimi i furnizimit me ujë edhe për faktin e mungesës totale të trajtimit të ujërave të zeza. Cilësia e shkarkimit si dhe besueshmëria e trajtimit të ujërave të zeza, janë dy fusha ku aktualisht, ne ende nuk mundur të bëjmë një vlerësim të performancës së KRU.

Nga të shtatë KRU vetëm dy prej tyre KRU 'Radoniqi' dhe 'Hidromorava', kanë treguar trende pozitive. KRU 'Radoniqi', me 5.3% dhe KRU 'Hidromorava', me 4.4%, po ashtu, janë dy kompani më profitabile nga të gjitha kompanitë e tjera në vitin 2013.

Pesë KRU-të, e tjera KRU 'Prishtina', 'Hidroregjioni Jugor', 'Bifurkacioni', 'Hidrodrini' dhe 'Mitrovica' kanë shënuar trende negative të performancës së tyre të përgjithshme në vitin 2013/2012. KRU 'Hidrodrini', ka pasur trende me të theksuara të përkeqësimit (12.2%), të pasuar nga Bifurkacion (6.2%) dhe Mitrovica (6.1%).

KRU 'Prishtina', në vitin e shqyrtuar 2013 në raport me vitin 2012, ka shënuar ulje të dukshme në performancën e saj për 5.5% performancë më të dobët ka treguar në furnizim me ujë, shërbime të ujërave të zeza dhe profitabilitet, përderisa trend të përmirësimit ka shënuar efikasitetin e arkëtimit.

Nga të gjitha KRU edhe më tej performancë të dobët ka vazhduar të tregoj KRU 'Mitrovica', për më tepër performanca e saj në 2013 edhe më tej është përkeqësuar në krahasim me vitin 2012 për 6.1%, në përgjithësi aspektet financiare janë problemet me akute në këtë kompani.




Figura 29, paraqet rezultatet në vlerësimin e përfundimit të përgjithshme të KRU

KRU ‘Radoniqi’, është kompania me performancën e përgjithshme më të mirë në vitin 2013 me gjithsej 68%, të pikëve nga maksimumi prej 100%, njëkohsisht është edhe kompania me përmirësimin më të lartë të performancës së përgjithshme në vitin 2013 në raport me vitin 2012.

Edhe, KRU ‘Hidromorava’, ka shënuar një përmirësim të ndjeshëm të performancës së saj në 2013 dhe këtë vit është ranguar në pozitën e dytë. Këto dy KRU kanë shënuar, progres në furnizim me ujë dhe në shkallën e profitabilitetit, përderisa performancë pak më të dobët kanë treguar tek shërbimi i ujërave të zeza dhe në shkallën e arkëtimit.

E befasishtë është rënia e lartë në rangim e KRU ‘Hidrodrini’, ajo nga pozita e parë në vitin 2012, tani në vitin 2013 është ranguar si e para fundit nga të gjitha kompanitë e tjera. Performanca e saj më e dobët është shfaqur në furnizimin me ujë, shërbime të ujërave të zeza si dhe shkallën e profitabilitetit, ndonëse shkalla e arkëtimit ka qenë dukshëm më e përmirësuar në vitin 2013/2012. Ne do të bëjmë, analiza me detale në të ardhmen për të vlerësuar se sa performanca e KRU ‘Hidrodrinit’, është ndikuar nga integrimi i Nj.O. të Deçanit i ndodhur në vitin 2013.

Në pozitë të fundit e ranguar vazhdon të jetë KRU ‘Mitrovica’, performanca e saj është më e dobët në të gjitha fushat. Asnjë pikë nuk ka arritur të marrë në efiçencën financiare (shkallën e profitabilitetit dhe arkëtimit) e cila ka shënuar trendet negative në 2013/2012. Niveli i përgjithshëm i performancës prej 39.6%, prej maksimumit të mundshëm nga 100%, lenë shumë për të dëshiruar.

3.5 Përgjegjshmëria e KRU-ve ndaj ZRRUK-it

Për të pasur një rezultat sa më thelbësor me efekte të mëdha dhe të qëndrueshme, nga proceset rregullatore të zbatuara nga ZRRUK, esenciale është përgjegjshmëria dhe përkushtimi i përmbushjes në mënyrë sa më cilësore dhe me kohë i të gjitha kërkesave rregullatore.

Me qëllim të avancimit të proceseve rregullatore kemi bërë vlerësimin e përgjegjshmërisë së KRU-ve ndaj ZRRUK-it. Për këtë qëllim kemi përdorur disa kriteret të cilat janë tërësisht nën kontrollin e menaxhmentit të kompanive e që janë:

- dorëzimi me kohë i raportimit të të dhënave,
- respektimi i afateve kohore dhe kualiteti i informacioneve ndaj kërkesave tarifor,
- pagesa e taksës vjetore të licencimit si dhe
- përgjigja në obligimet dhe kërkesat e tjera të ligjore dhe aktivitetet e tjera rregullatore.

Rangimi është bërë duke i poentuar KRU-të sipas metodologjisë vijuese: të gjitha kriteret kanë peshë të njëjtë dhe janë vlerësuar me nga një pikë. Për secilin kriter, KRU-së që ka pasur performancën më të mirë i është dhënë 1.0 pikë ndërsa KRU-së që ka pasur performancën më të keqe 0.0 pikë. KRU-të tjera janë poentuar me pikë ndërmjet 1.0 dhe 0.0 në mënyrë proporcionale.

Tabela 6, Rezultatet e vlerësimit dhe rangimi

Pozita	KRU	Pikët totale
1	Radoniqi	3.67
2	Hidroregjioni Jugor	3.50
3	Prishtina	3.33
4	Hidromorava	2.17
5	Bifurkacioni	2.17
6	Mitrovica	1.83
7	Hidrodrini	1.50

Kompanitë, kryesisht kanë reaguar në mënyrë të përgjegjshme në dy kriteret e para (dorëzimi me kohë i raporteve të të dhënave dhe kërkesave tarifore).

Përgjegjshmëria e KRU ka qenë më e vogël, tek kriteri i pagesës së taksës vjetore të licencimit si dhe kërkesave të tjera rregullatore siç janë p.sh: plotësimi i kushteve të licencës si dhe përmbushja e rekomandimeve të dhëna përmes raporteve të inspektimit (faturat e shërbimit, trajtimi i ankesave të konsumatorëve, etj)

KRU 'Mitrovica' nuk ka qenë e rregullt në pagesën e taksës vjetore të licencës, po ashtu edhe KRU 'Bifurkacioni', ka pasur pak ngecje në këtë drejtim.

KRU ,Radoniqi, Hidroregjioni Jugor dhe Prishtina, janë tri kompani të cilat reagojnë, mjaft me përgjegjësi ndaj kërkesave të ZRRUK-it.

Në përgjithësi, vlerësimi i ZRRUK është se kompania më e përgjegjshme ndaj kërkesave Rregullatore gjatë vitit 2013 ka qenë KRU 'Radoniqi' e cila ka mbledhur 3.67 pikë nga maksimumi prej 4 pikëve të mundshme.

Pjesa B:

Performanca e Sektorit të Shërbimeve të Ujësjetës-Kanalizimit

4 PERFORMANCA E SEKTORIT

Në këtë pjesë të raportit është vlerësuar performanca e sektorit për një periudhë 5 vjeçare (2009-2013), diskutimi i të arriturave në raport me objektivat në planet e bizneseve të aprovuar rregullatore.

4.1 Uji i prodhuar, shitjet dhe uji i pa-faturuar

Në Figurën 28, është paraqitur Uji i pa-faturuar shprehur si diferenca në mes ujit të prodhuar dhe ujit të shitur (faturuar), uji i faturuar si dhe prodhimi të shprehura në baza vjetore për pesë vite me radhë.




Figura 30, Prodhimi i ujit, shitjet dhe uji i pa-faturuar

Prodhimi i ujit në nivel sektori prej vitit 2009-2011 ka shënuar rritje nga viti në vit mirëpo nga viti 2012 poashtu edhe gjatë vitit 2013 kemi rënje të prodhimit të ujit e cila është ndikuar nga zvogëlimi i prodhimit gati tek të gjitha KRU në përjashtim të KRU 'Hidrodrinit' dhe 'Hidromoravës tek të cilat prodhimi është më i lartë gjatë vitit 2013 në raport me vitin 2012. Vlenë të theksohet se rritja e prodhimit të KRU 'Hidrodrini' ka ardh si shkak i marrjes nën menaxhim të NJ.O. të Deçanit gjatë këtij viti.

Gjatë vitit 2013 nga të gjitha kompanitë janë prodhuar mbi 134 milion m³ ujë të pijshëm dhe në raport me vitin 2012, kemi për mbi 3 milion m³ me pak prodhim se sa në vitin 2012.

Shitja e ujit gjatë vitit 2013 sillet rreth 58 milion m³ dhe krahasuar me vitin 2012 pothuajse ka mbetë në pozitën e njëjtë me një ngritje të vogël me 58 milion m³.

Uji i shitur, gjatë kësaj periudhe pesë vjeçare nga viti në vit ka, shënuar një përmirësim shumë të vogël.

Gjatë vitit 2013 UPF në nivel sektori, qëndron në nivelin prej 57% apo në vlerë sasiore kjo vlerë është 76 milion m³, ndërsa nëse bëjmë krahasim me vitin 2012 gjatë vitit 2013 kemi një përmirësim për 1%. vetëm KRU 'Prishtina', ka mbi 20mil.m³ UPF, nga prodhimi i saj vjetor prej 40mil.m³.

Uji i Pa faturuar (UPF) nga KRU, është tepër i lartë dhe në mesatare që nga viti 2009, sillet mbi 81 mil.m³ ujë të pafaturara nga mesatarja e prodhimit prej 138 mil.m³ nga e njëjta. Ky është një nivel i pa akceptueshem dhe larg normave të vendeve europiane. Përveç faktit se UPF, nuk sjellë të ardhura për kompaninë, krijon shpenzime shtesë për prodhimin dhe distribuimin e tij. Për më tepër është për

keqardhje se humbet një sasi e konsiderueshme e ujit e cila është shumë e nevojshëm për të plotësuar kërkesat gjithnjë e në rritje të konsumatorëve për ujë.

Përkundër, angazhimeve vetanake por edhe të mbështetjes së herë pas herë të donatorëve, KRU nuk ishin në gjendje që të zgjidhnin situatën alarmuese të humbjes së ujit. Përkundrazi, UPF ka stagnuar në nivel të lartë me disa ndryshime minore e cila me tepër mund ti atribuohet lëvizjeve në prodhimin e ujit.

Në botë UPF, sillet në nivele 10% deri në 15%, tek ne në Kosovë një përqindje e tillë e humbjeve të ujit është vështirë të arrihen, para se gjithash edhe për shkakun se sistemi i ujësjellësit, kryesisht është i vjetruar dhe me gypa jo kualitativ, pra është jo reale pritja që KRU, të bëjnë ndonjë ndryshim substancial brenda një periudhe të shkurtë kohore, aqë me tepër kur jemi dëshmitar se momentalisht, nuk ka ndonjë program të duhur për reduktimin e UPF-së e cila do të mbulonte aspektet e ndryshme të problemit.

4.2 Mbulueshmëria me shërbime

Ky tregues paraqet raportin në mes konsumatorëve aktiv të kategorisë së amvisërise dhe ekonomive familjare e dhënë kjo e fundit e marrë nga Agjensioni i Statistikave të Kosovës. Numri total i popullsisë të cilëve u ofrohet shërbim në zonat operuese të shtatë KRU vlerësohet të jetë mbi 1.3 milion banorë nga 1.7 milion sa janë në total.




Figura 31, Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit dhe të kanalizimit

Në figurën 29, është paraqitur Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit dhe ujërave të zeza e shprehur si përqindje e konsumatorëve shtëpiak në raport me popullatën në zonën e shërbimit të KRU.

Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit dhe të ujërave të zeza gjatë pesë viteve nga viti në vit ka pas një ngritje të vazhdueshme.

Gjatë vitit 2013 mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit ka arritur nivelin rreth 82% në raport me vitin 2009 sa ishte 65%, që do të thotë se kemi përmirësim për 17%. Po ashtu edhe tek mbulueshmëria me shërbime të ujërave të zeza kemi trend pozitiv sa i përket krahasimit të viteve 2009 me 2013 me vlerë nga 50% në 60%, apo 10% rritje gjatë kësaj periudhe 5 vjeçare.

Numri total i konsumatorëve shtëpiak në nivel sektori gjatë vitit 2013, në raport me vitin 2012, në shërbime të furnizimit me ujë është rritur, për 17,199 konsumatorë, përderisa numri i konsumatorëve

shtëpiak në shërbime të ujërave të zeza është rritur për 10,655 duke i tejkaluar planifikimet e projektuara të cilat kanë qenë që gjatë, këtyre tri viteve, baza e konsumatorëve të rritet çdo vit nga 10,000 konsumatorë, në furnizim me ujë dhe konsumatorë në shërbime të ujërave të zeza.

4.3 Të ardhurat e planifikuara, qarkullimi dhe para ja e gatshme e arkëtuar

Qarkullimi nënkupton të hyrat nga faturimi i rregullt dhe të hyrat tjera operative për shërbime të ujit dhe ujërave të zeza.

Ne figura 25, është pasqyruar efikasiteti mesatar i qarkullimit dhe inkasimit gjatë 5 viteve, dhe jep një pasqyrë me të qartë të qarkullimit dhe arkëtimit gjatë viteve duke eliminuar shtrembërime që mund të ndodhin gjatë një viti financiar.




Figura 32, Performanca financiare e sektorit

Edhe, pse ZRRUK gjatë procesit tarifar (2012-2014) ka qenë me i kujdesshëm se sa që ishte në procesin e kaluar (2009-2011) gjatë përcaktimit të objektivave, të cilat do të jenë realisht të arritshme por njëkohësisht edhe sfiduese. Ne me keqardhje konstatojmë se objektivat e planifikuara e sidomos ato në lidhje me faturimin, arkëtimin, nuk kanë mundur të arrihen. Për më tepër në vitin 2013. Qarkullimi i realizuar edhe me tepër ka devijuar nga objektiva e planifikuar duke krijuar një diferencë edhe më të madhe se sa ishte në vitin 2012. Njëjtë ka ndodhur edhe me arkëtimin e keshit të planifikuar në raport me realizimin aktual.

Në përgjithësi KRU, janë duke përmirësuar efikasitetin e qarkullimit dhe arkëtimit vit pas viti, si në vlerë monetare ashtu edhe në përqindje (%). Vlen të përmendet se edhe pse përmirësimi është gradual me rëndësi të veçantë është se ai është i qëndrueshëm.

Efiçenca e qarkullimit¹¹ në vlerë monetare në nivel sektori gjatë vitit 2013, ka shënuar përmirësim për 476,365.72€ apo shprehur në përqindje për 2% në raport me vitin 2012, ky përmirësim i lehtë i atribuohet zgjerimit të bazës së konsumatorëve, vit pas viti e më pas edhe ngritjes së efikasitetit të të ardhurave nga faturimi.

¹¹ Qarkullimi ka përfshirë të hyrat nga faturimi i rregullt për shërbimet e ujit dhe të ujërave të zeza si dhe të hyrat nga aktivitetet operative duke përfshirë të hyrat jo operative (financiare).

Efiçenca e arkëtimit¹², në vitin 2013 po ashtu ka shënuar përmirësim në vlerë monetare për 524,531, apo shprehur në përqindje për 3% në krahasim me vitin 2012.

Efiçenca e arkëtimit ne raport me efiçencën e qarkullimit në nivel të sektorit ne vitin 2013 ishte 71% dhe me e lartë për 8% krahasuar me vitin 2009, të cilat vlera mund ti gjeni edhe ne tabelën e me poshtme.

Tabela 7. Qarkullimi dhe arkëtimi sipas viteve

Vitet	Qarkullimi	Arkëtimi	Arketimi/Qarkullimi
2009	23,289,745.25	14,794,280.14	64%
2010	25,884,531.34	17,458,714.86	67%
2011	26,051,994.94	18,156,979.37	70%
2012	29,111,469.23	20,609,696.24	71%
2013	29,587,834.95	21,134,227.62	71%

4.4 Shpenzimet kapitale për furnizim me ujë dhe shërbime të ujërave të zeza

Një faktor tjetër shumë i rëndësishëm në sektor, janë investimet. Në këtë seksion, kemi paraqitur analizën e shpenzimeve kapitale të shtatë KRU, reale dhe ato të planifikuara përgjatë procesit tarifor (2009-2011) i cili ka përfunduar, dhe procesit aktual (2012-2014) për vitet 2012 dhe 2013.

Është e qartë se financimi drejt sektorit të ujit dhe ujërave të zeza ka nevojë për mbështetje dhe përpjekje të bashkërenduara nga aktorë të ndryshëm. Edhe pse ka pasur fonde të kanalizuar në drejtim të investimeve në këtë sektor, ka ende nevojë të bëhet shumë më tepër, duke pasur parasysh kërkesat e mëdha për investime.

Nga të gjitha KRU, është pritët që të realizojnë investime të konsiderueshme në shërbimin e furnizimit me ujë dhe në shërbimin e ujërave të zeza dhe nga totali i shumës së planifikuar për periudhën trevjeçare tarifore (2012-2014), prej afro 95 mili.€, me një ndarje prej përafërsisht me 2/3 në furnizim me ujë dhe 1/3 në shërbimin e ujërave të zeza. Nga mjetet vetanake të KRU është planifikuar të investohen rreth 25 mil.€ shpenzime kapitale në të dy shërbimet (furnizim me ujë dhe shërbime të ujërave të zeza).

Tabela 8. Investimet kapitale 2009-2013

Vlera totale e shpenzimeve kapitale për ujë dhe ujëra të zeza					
Kompania	2009	2010	2011	2012	2013
KRU 'Prishtina'	1,021,667	871,374	1,054,660	5,079,692	8,989,021
KRU 'Hidroregjioni Jugor'	251,085	193,405	1,900,664	3,388,493	1,546,082
KRU 'Hidrodrini'	157,533	1,489,854	856,345	4,742,893	897,677
KRU 'Mitrovica'	380,848	63,055	780,543	21,851	2,052,107
KRU 'Radoniqi'	12,728	163,969	173,473	397,359	1,342,832
KRU 'Bifurkacioni'	247,817	182,746	272,112	702,392	58,209
KRU 'Hidromorava'	1,561,406	1,191,900	152,364	1,367,080	32,211
Totali	3,633,084	4,156,302	5,190,161	15,699,759	14,918,139

¹² Keshi (Efiçenca e arkëtimit) ka përfshirë arkëtimin nga faturimi i rregullt për shërbimet e ujit dhe të kanalizimit si dhe të hyrat nga aktivitetet e tjera operative.

Siç vërehet edhe nga tabela me sipër kompanitë nga viti 2009 deri në vitin 2012, kanë rritur vlerën e investimeve kapitale në ujë dhe ujëra të zeza, e cila rritje nuk ka vazhduar edhe në vitin 2013. Në vitin 2013 vlera investimeve të kapitale ka rënë për 781,620€ ose 5% krahasuar me vitin 2012. Në pesë vitet e fundit vlera e përfituar nga grantet në vlerë monetare ka qenë prej 36,673,702€ ose 84%, dhe ato të cilat kanë përfituar më së shumti kanë qenë, KRU “Prishtina”, ‘Hidroregjioni Jugor’ dhe ‘Hidrodrini’.

Në procesin tarifor (2009-2011) kompanitë kanë arritur që cakun e planifikuar ta realizojnë vetëm 12%, ndërsa procesi tarifor 2012-2014, viti 2012 dhe 2013 shënon ngritje në 29% me ndihmën e donacioneve. Shumica e investimeve kapitale që janë realizuar në këto vite, kryesisht janë financuar nga donatorët e ndryshëm të cilët e kanë mbështetur rikonstruimin dhe zhvillimin e këtij sektori.

Mungesa e realizimit të investimeve të parapara sipas lartësisë dhe dinamikës së planifikuar, qoftë nga mjetet vetanake qoftë me mjetet financiare nga donatorët nuk do të sjellë përmirësimet e planifikuara në veçanti, do të ketë ndikim në mos mirëmbajtjen e duhur dhe rritjen e aseteve të cilat janë parakushte për ofrimin e shërbimeve të mira dhe të qëndrueshme.

Pjesa C

Performanca e Furnizuesit të Ujit me Shumicë

5 PERFORMANCA E FURNIZUESIT TË UJIT ME SHUMICË

ZRRUK, është përgjegjës për rregullimin e pjesës së afarizmit të NHE 'Iber Lepenci' e cila ka të bëjë me furnizimin e ujit me shumicë për KRU 'Mitrovica' dhe KRU 'Prishtina'. Në vazhdim janë dhënë të dhëna statistikore dhe disa tregues të performancës për të parë trendet e zhvillimit të performancës së NHE 'Iber Lepenci', në vitin 2013.

Tabela 9, Të dhënat statistikore për NHE 'Ibër-Lepenc'

Të dhënat statistikore për 2012 / 2013	2012	2013
Vëllimi ujit me shumicë të faturuar (m3)	17,866,656	17,817,840
Faturimi për ujiin me shumicë (€)	384,449	383,399
Arkëtimi për ujiin me shumicë (€)	365,189	100,934
Kostoja e operimit për furnizimin e ujit me shumicë (€)	318,700	358,495
Numri i punëtorëve të angazhuar në furnizimin e ujit me shumicë	22	27

